

**Raiffeisen INVEST – Shoqëria Administruese e Fondeve të Pensionit  
dhe Sipërmarrjeve të Investimeve Kolektive sh.a.  
Pasqyrat financiare  
më dhe për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2023  
(me raportin e Audituesit të pavarur)**

# Përmbajtja

## Faqe

Raporti i Audituesit të Pavarur	i-iii
Pasqyrat Financiare	
Pasqyra e Pozicionit Financiar	1
Pasqyra e Fitim ose Humbjes dhe të Ardhurave Gjithëpërfshirëse	2
Pasqyra e Ndryshimeve në Kapital	3
Pasqyra e Flukseve të Parasë	4
Shënimet Shpjeguese të Pasqyrave Financiare	5-31

## RAPORTI I AUDITUESIT TË PAVARUR

**Për aksionarët e “Raiffeisen Invest” sh.a, Shoqëri Administruese e Fondeve të Pensionit dhe Sipërmarrjeve të Investimeve Kolektive**

### Opinionit

Ne kemi audituar pasqyrat financiare të Raiffeisen Invest (këtu e më poshtë i referuar si, “Shoqëria”) të cilat përfshijnë pasqyrën e pozicionit financiar më 31 dhjetor 2023 dhe pasqyrën e fitimit ose humbjes dhe të ardhurave gjithëpërfshirëse, pasqyrën e ndryshimeve në kapital dhe pasqyrën e flukseve të parasë për vitin e mbyllur në këtë datë, si edhe nga një përmbledhje e politikave materiale të kontabilitetit dhe shënime të tjera shpjeguese.

Sipas opinionit tonë, pasqyrat financiare paraqesin në mënyrë të drejtë, në të gjitha aspektet materiale, pozicionin financiar të Shoqërisë më 31 dhjetor 2023 si edhe të performancës së saj financiare dhe parave për vitin e mbyllur në këtë datë, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (“SNRF”).

### Baza e Opinionit

Ne e kryem auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (“SNA”-të). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve janë përshkruar në paragrafin e emërtuar “Përgjegjësitë e audituesit për auditimin e pasqyrave financiare” të këtij raporti. Ne shprehim pavarësinë tonë nga Shoqëria në përputhje me Kodin Ndërkombëtar të Etikës së Kontabilistëve Profesionistë i vendosur nga Bordi i Kontabilistëve për Standardet Ndërkombëtare të Etikës (përfshirë Standardet Ndërkombëtare të Pavarësisë) (kodi “BKSNE”) dhe me kërkesat etike të aplikueshme për auditimin e pasqyrave financiare në Shqipëri, si edhe, kemi përmbushur përgjegjësitë tona të tjera etike në përputhje me këto kërkesa dhe me kodin BKSNE.

Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të mbështetur bazën për opinionin tonë të auditimit.

### Informacione të tjera

Drejtimi është përgjegjës për informacionet e tjera. Informacionet e tjera përfshijnë informacionet që paraqiten në raportin vjetor, përgatitur nga Drejtimi në përputhje me Nenet 17 dh 19 të Ligjit nr. 25/2018 datuar 10 maj 2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, i ndryshuar, por nuk përfshin pasqyrat financiare dhe raportin tonë të audituesit mbi këto pasqyra. Raporti vjetor parashikohet të na vihet në dispozicion pas datës së këtij raporti të audituesit të pavarur. Opinionit ynë mbi pasqyrat financiare nuk mbulon informacionet e tjera dhe ne nuk shprehim asnjë lloj opinionit në lidhje me këto informacione.

Në lidhje me auditimin e pasqyrave financiare, ne kemi përgjegjësinë të lexojmë informacionet e tjera, të identifikuar më lart kur ato të na vihen në dispozicion dhe të vlerësojmë nëse këto informacione kanë pasaktësi materiale me pasqyrat financiare, apo me njohjen që ne kemi marrë gjatë auditimit ose përndryshe, nëse duket se ato janë me anomali materiale. Kur të lexojmë Raportin Vjetor, nëse, në bazë të punës që kemi kryer, arrijmë në përfundimin se ka një anomali materiale të informacioneve të tjera, ne na crochët të raportojmë këtë fakt. Nuk kemi asgjë për të raportuar për këtë fakt.

## **Përgjegjësitë e drejtimit dhe palëve të ngarkuara me qeverisjen për pasqyrat financiare**

Drejtimi është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare në përputhje me SNRF-të, si edhe për sistemin e kontrollit të brendshëm, i cili në masën që përcaktohet nga drejtimi, është i nevojshëm për të bërë të mundur përgatitjen e pasqyrave financiare pa anomali materiale, si pasojë e mashtrimeve apo gabimeve. Në përgatitjen e pasqyrave financiare, drejtimi është përgjegjës për vlerësimin e aftësisë së Shoqërisë për të vazhduar aktivitetin e tij në bazë të parimit të vijimësisë, të paraqesë në shënimet shpjeguese, nëse është e aplikueshme, çështje që lidhen me vazhdimësinë e aktivitetit të Shoqërisë dhe të përdorë parimin kontabël të vijimësisë, përveç rasteve kur drejtimi ka ose për qëllim të likuidojë aktivitetin, ose të ndërpresë operacionet, ose nuk ka asnjë alternativë tjetër reale, përveç se sa më lart. Palët e ngarkuara me qeverisjen janë përgjegjëse për mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Shoqërisë.

## **Përgjegjësia e audituesit për auditimin e pasqyrave financiare**

Objektivat tona janë të arrijmë një siguri të arsyeshme lidhur me faktin nëse pasqyrat financiare në tërësi nuk kanë anomali materiale, për shkak të mashtrimeve apo gabimeve, dhe të lëshojmë një raport auditimi që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është një siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci që një auditim i kryer sipas SNA-ve do të identifikojë gjithmonë një anomali materiale kur ajo ekziston. Anomalitë mund të vijnë si rezultat i gabimit ose i mashtrimit dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose të marra së bashku, pritet që në mënyrë të arsyeshme të influencojnë vendimet ekonomike të përdoruesve, të marra bazuar në këto pasqyra financiare.

Si pjesë e auditimit në përputhje me SNA-të, ne ushtrojmë gjykimin profesional dhe ruajmë skepticizmin tonë profesional gjatë gjithë procesit të auditimit. Gjithashtu, ne:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rrezikun e anomalive materiale në pasqyrat financiare, si pasojë e mashtrimeve apo gabimeve, hartojmë dhe zbatojmë procedurat përkatëse në përgjigje të këtyre rreziqeve, si edhe marrim evidencë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të krijuar një bazë për opinionin tonë. Rreziku i mos zbulimit të një anomalie materiale, si pasojë e mashtrimit është më i lartë se rreziku i moszbulimit të një anomalie si pasojë e gabimit, për shkak se, mashtrimi mund të përfshijë fshehje të informacionit, falsifikim të informacionit, përvetësime të qëllimshme, keqinterpretime, apo shkelje të kontrollit të brendshëm.
- Marrim një kuptueshmëri të sistemeve të kontrolleve të brendshme të aplikueshme për procesin e auditimit me qëllim hartimin e procedurave të auditimit të përshtatshme me rrethanat, por jo për të shprehur një opinion mbi efektivitetin e sistemeve të kontrolleve të brendshme të Shoqërisë.
- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave kontabël të përdorura dhe arsyetueshmërinë, e çmuarjeve kontabël të kryera si edhe paraqitjen e shënimeve shpjeguese përkatëse të hartuara nga drejtimi.
- Shprehemi në lidhje me përshtatshmërinë e parimit të vijimësisë të përdorur nga drejtimi, dhe bazuar në evidencat e marra gjatë auditimit, nëse një pasiguri materiale ekziston, atëherë mund të shkaktojë dyshime të rëndësishme mbi aftësinë e Shoqërisë për të vazhduar në vijimësi.

Nëse arrijmë në përfundimin se ekziston një pasiguri materiale, ne duhet të tërheqim vëmendjen në raportin tonë të auditimit me reference në shënimin shpjegues përkatës, ose, nëse shënimet nuk janë të përshtatshme, ne duhet të modifikojmë opinionin tonë. Përfundimet tona bazohen në evidencën e auditimit të marrë deri në datën e raportit të audituesit tonë. Megjithatë, ngjarjet ose kushtet në të ardhmen mund të shkaktojnë ndërprerje të aftësisë së Shoqërisë për vazhduar në vijimësi.

## Përgjegjësia e audituesit për auditimin e pasqyrave financiare (vazhdim)

- Vlerësojmë paraqitjen e përgjithshme, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare, duke përfshirë shënimet shpjeguese dhe nëse pasqyrat financiare prezantojnë transaksionet dhe ngjarjet thelbësore në një mënyrë që arrin prezantimin e drejtë.

Ne komunikojmë me palët e ngarkuara me qeverisjen e Shoqërisë, ku përveç çështjeve të tjera, komunikojmë edhe qëllimin dhe kohën e planifikuar të auditimit, gjetjet kryesore të auditimit, përfshirë çdo mangësi të rëndësishme në sistemin e kontrollit të brendshëm që është identifikuar gjatë auditimit tonë.

*Deloitte Audit Albania shpk*

Deloitte Audit Albania shpk

Rruga e Kavajës, ish parku i mallrave, Kompleksi Delijorgji, Godina H

Tirana, Albania

Numër unik identifikimi i subjektit (NUIS): L41709002H

Audituesi ligjor

Partner Angazhimi

Enida Cara



Tiranë, Shqipëri

29 mars 2024

**Raiffeisen INVEST – Shoqëri Administruese e Fondeve të Pensionit dhe Sipërmarrjeve të Investimeve Kolektive sh.a.**

Pasqyra e pozicionit financiar më 31 dhjetor 2023

(të gjitha vlerat janë në Lek, përveçse kur është shprehur ndryshe)

		31 dhjetor 2023	31 dhjetor 2022
<b>AKTIVET</b>			
Paraja dhe ekuivalentët e saj	8	543,473,825	548,539,972
Llogari të arkëtueshme nga Fondet	9	47,893,399	43,978,033
Aktive financiare të mbajtura me kosto të amortizuar	10	20,548,848	22,226,722
Parapagime		3,174,607	1,445,550
Aktive materiale	11	8,050,141	8,828,808
Aktive jomateriale	12	11,670,548	10,463,569
E drejta e perdorimit	11	21,414,149	24,269,353
Tatim fitimi i parapaguar	20	36,975,301	5,370,080
<b>TOTALI I AKTIVEVE</b>		<b>693,200,819</b>	<b>665,122,087</b>
<b>DETYRIMET</b>			
Tatim fitimi i pagueshëm		-	-
Detyrime të tjera	13	26,183,921	32,167,799
Detyrime qiraje	14	21,546,778	24,243,199
<b>TOTALI I DETYRIMEVE</b>		<b>47,730,699</b>	<b>56,410,998</b>
<b>KAPITALI</b>			
Kapitali aksioner	15	90,000,000	90,000,000
Rezerva ligjore	15	9,000,000	9,000,000
Fitim/(Humbje) të mbartura		546,470,120	509,711,090
<b>TOTALI I KAPITALIT</b>		<b>645,470,120</b>	<b>608,711,090</b>
<b>TOTALI I KAPITALIT DHE DETYRIMEVE</b>		<b>693,200,819</b>	<b>665,122,087</b>

Pasqyra e pozicionit financiar duhet të lexohet së bashku me shënimet e paraqitura në faqet 5 deri në 31, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

Këto pasqyra financiare u miratuan nga Këshilli i Administrimit të Raiffesien INVEST- Shoqëria Administruese e Fondeve të Pensionit dhe Sipërmarrjeve të Investimeve Kolektive sh.a. më 21 mars, 2024.

Administratore e përgjithshme

Zv. Administratore e Përgjithshme

Znj. Edlira KONINI

Znj. Alketa EMINI



**Raiffeisen INVEST – Shoqëri Administruese e Fondeve të Pensionit dhe Sipërmarrjeve të Investimeve Kolektive sh.a.**  
 Pasqyra e fitimit ose e humbjes dhe e të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2023 (të gjitha vlerat janë në Lek, përveçse kur është shprehur ndryshe)

	Shënime	31 dhjetor 2023	31 dhjetor 2022
<b>Të ardhurat</b>			
Tarifa të administrimit të Fondeve	15	498,907,219	745,181,931
Të ardhura nga interesi i llogaritur duke përdorur metodën e interesit efektiv	16	12,164,734	2,496,973
Tarifa të largimit nga fondi	9	2,142,071	2,051,898
Të ardhura te tjera		2,343,101	5,341,637
		<b>515,557,125</b>	<b>755,072,438</b>
<b>Shpenzimet</b>			
Shpenzime për personelin	17	(55,293,230)	(54,542,630)
Zhvlerësimi dhe amortizimi	11,12	(6,467,717)	(5,629,424)
Amortizimi i te drejtes se perdorimit		(2,855,204)	(2,855,106)
Shpenzime të tjera operative	18	(351,509,505)	(527,769,004)
Shpenzime të tjera		<b>(416,125,657)</b>	<b>(590,796,164)</b>
		(169,188)	(319,617)
(Humbje)/fitim nga kursi i këmbimit		<b>(169,188)</b>	<b>(319,617)</b>
		<b>99,262,280</b>	<b>163,956,657</b>
<b>Fitimi neto para tatimit</b>			
		(62,503,250)	(97,687,261)
Tatim fitimi	19	<b>36,759,030</b>	<b>66,269,397</b>
<b>Fitimi neto pas tatimit</b>		-	-
Të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse		-	-
<b>Totali i të ardhurave gjithëpërfshirëse për vitin</b>		<b>36,759,030</b>	<b>66,269,397</b>

Pasqyra e fitimit ose e humbjes dhe e të ardhurave te tjera gjithëpërfshirëse duhet të lexohet së bashku me shënimet e paraqitura në faqet 5 deri në 31, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

**Raiffeisen INVEST – Shoqëri Administruese e Fondeve të Pensionit dhe Sipërmarrjeve të Investimeve Kolektive sh.a.**

Pasqyra e ndryshimeve në kapital për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2023  
(të gjitha vlerat janë në Lek, përveçse kur është shprehur ndryshe)

	Kapitali aksioner	Rezerva ligjore	Fitim(Humbje) të mbartura	Totali
<b>Gjendja më 1 janar 2022</b>	<b>90,000,000</b>	<b>9,000,000</b>	<b>565,441,693</b>	<b>664,441,693</b>
Fitimi i vitit	-	-	66,269,397	66,269,397
Të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse	-	-	-	-
<b>Totali i të ardhurave gjithëpërfshirëse</b>	<b>-</b>	<b>-</b>	<b>66,269,397</b>	<b>66,269,397</b>
Pagese dividendi	-	-	(122,000,000)	(122,000,000)
<b>Gjendja më 31 dhjetor 2022</b>	<b>90,000,000</b>	<b>9,000,000</b>	<b>509,711,090</b>	<b>608,711,090</b>
Fitimi i vitit	-	-	36,759,030	36,759,030
Të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse	-	-	-	-
<b>Totali i të ardhurave gjithëpërfshirëse</b>	<b>-</b>	<b>-</b>	<b>36,759,030</b>	<b>36,759,030</b>
Pagese dividendi	-	-	-	-
<b>Gjendja më 31 dhjetor 2023</b>	<b>90,000,000</b>	<b>9,000,000</b>	<b>546,470,120</b>	<b>645,470,120</b>

Pasqyra e ndryshimeve në kapital duhet të lexohet së bashku me shënimet e paraqitura në faqet 5 deri në 31 të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.



**Raiffeisen INVEST – Shoqëri Administruese e Fondeve të Pensionit dhe Sipërmarrjeve të Investimeve Kolektive sh.a.**

Pasqyra e ndryshimeve në kapital për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2023

(të gjitha vlerat janë në Lek, përveçse kur është shprehur ndryshe)

	Shënime	31 dhjetor 2023	31 dhjetor 2022
<b>Fluksi monetar nga aktiviteti operativ</b>			
<b>Fitimi i vitit</b>		<b>36,759,030</b>	<b>66,269,397</b>
<b>Rregulluar me:</b>			
Zhvlerësimi dhe amortizimi	11,12	9,322,921	8,484,530
Të ardhura nga interesi		(12,164,734)	(2,496,973)
Tatim fitimi		62,503,250	97,687,261
Shpenzimi i interesit	14	363,323	353,055
		<b>96,783,791</b>	<b>170,297,270</b>
<b>Ndryshime në:</b>			
Të arkëtueshme nga fondet	9	(3,915,366)	31,271,534
Aktive të tjera		(1,729,057)	(807,980)
Detyrime të tjera	13	(5,983,877)	4,519,748
<b>Mjete monetare nga aktiviteti operativ</b>		<b>85,155,491</b>	<b>205,280,571</b>
Interesi i arkëtuar		11,767,942	1,823,822
Tatim fitimi i paguar	19	(94,108,471)	(109,910,787)
<b>Mjete monetare neto gjeneruar nga aktiviteti operativ</b>		<b>2,814,961</b>	<b>97,193,606</b>
<b>Flukset monetare nga aktiviteti investues</b>			
Blerja e aktiveve afatgjata materiale	11	(3,061,850)	(1,055,956)
Blerja e aktiveve afatgjata jomateriale	12	(3,311,775)	(3,124,174)
Blerje e aktiveve financiare të mbajtura deri në maturim	10	(20,433,731)	-
Shitje / Maturim i aktiveve financiare të mbajtura me kosto të amortizuar	10	22,000,000	-
<b>Para neto nga aktiviteti investues</b>		<b>(5,122,547)</b>	<b>(4,180,130)</b>
<b>Flukset monetare nga aktiviteti financues</b>			
Dividenti i paguar		-	(122,000,000)
Pagesa për detyrimet e qerasë		(2,758,561)	(2,981,073)
<b>Mjetet monetare neto të përdorura në aktivitetin investues</b>		<b>(2,758,561)</b>	<b>(124,981,073)</b>
akësimi/Rritje neto në mjete monetare dhe ekuivalentë të tyre gjatë vitit		(5,066,147)	(31,967,597)
<b>Paraja dhe ekuivalentët e saj më 1 janar</b>	<b>8</b>	<b>548,539,972</b>	<b>580,507,569</b>
<b>Paraja dhe ekuivalentët e saj më 31 dhjetor</b>	<b>8</b>	<b>543,473,825</b>	<b>548,539,972</b>

Pasqyra e flukseve të parasë duhet të lexohet së bashku me shënimet e paraqitura në faqet 5 deri në 31, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

# **Raiffeisen INVEST – Shoqëri Administruese e Fondeve të Pensionit dhe Sipërmarrjeve të Investimeve Kolektive sh.a.**

Pasqyra e ndryshimeve në kapital për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2023  
(të gjitha vlerat janë në Lek, përveçse kur është shprehur ndryshe)

---

## **1. Hyrje**

Raiffeisen INVEST- Shoqëri Administruese e Fondeve të Pensionit dhe Sipërmarrjeve të Investimeve Kolektive" sh.a. ("Shoqëria") është një shoqëri aksionere shqiptare me qendër në Tiranë. Shoqëria është regjistruar në Regjistrin Tregtar të Shqipërisë nga Gjykata e Tiranës me vendimin nr. 33825, i dates 18 korrik 2005. Zyrat qendrore ndodhen në Rugën Tish Dija, Kompleksi Kika 2, kati i dytë, Tiranë.

Shoqëria është licënsuar nga Autoriteti i Mbikqyrjes Financiare ("AMF") më 7 korrik 2005 (License Nr. 2) për të vepruar si shoqëri administruese e Fondeve të Pensionit Vullnetar në mbledhjen dhe investimin e fondeve të pensionit vullnetar dhe kryerjen e pagesave të pensionit. Gjithashtu, Shoqëria është licënsuar nga Autoriteti i Mbikqyrjes Financiare më 13 Dhjetor 2011 (License Nr. 1) për të vepruar si shoqëri administruese e aktiveve të sipërmarrjeve të investimeve kolektive.

Aktiviteti i Shoqërisë mbikqyret nga AMF, në përputhje me dispozitat e ligjit nr. 9572, datë 03 korrik 2006 "Për Autoritetin e Mbikqyrjes Financiare", ligjit nr.10197, datë 10 Dhjetor 2009 "Për fondet e pensionit vullnetar" dhe ligjit nr.10198, datë 10 Dhjetor 2009 "Për sipërmarrjet e investimeve kolektive".

Shoqëria ka një marrëveshje për shërbime depozituese për fondin e pensioneve me Bankën e Parë të Investimeve të Shqipërisë, me seli në Blv. "Dëshmorët e Kombit", Kulla Binjake 2, Kati 14, Tirana ("Banka Kujdestare").

Banka Kujdestare është e licëncuar nga Banka e Shqipërisë për të ofruar shërbime kujdestarie, depozitimi dhe të besimit (vendimi nr.13, datë 10.03.2010). Banka Kujdestare është gjithashtu e licëncuar nga AMF për të ofruar shërbime depozitimi për aktivet e fondit të pensionit (vendimi nr. 80, datë 30 gusht 2010) dhe sipërmarrjeve të investimeve kolektive (vendimi nr.1, datë 13.12.2011).

Aktiviteti kryesor i Shoqërisë është:

- menaxhimi i fondit të pensionit vullnetar nëpërmjet mbledhjes dhe investimit të fondeve bazuar në Ligjin nr. 10197, të datës 10 Dhjetor 2009 "Mbi fondet e pensionit vullnetar", si dhe në përputhje me parimin e shperndarjes së rrezikut (diversifikimit), si qëllim për të siguruar përfitime pensioni për personat që janë anëtarë të fondit. Shoqëria mund të sigurojë gjithashtu kryerjen e pagesave të pensionit;
- të themeloje dhe/ose të menaxhojë Sipërmarrje të Investimeve Kolektive bazuar në Ligjin nr. 10198, të dates 10 Dhjetor 2009 "Mbi sipërmarrjet e investimeve kolektive";
- të përformoje aktivitete të tjera siç përshkruhet në Ligjin nr. 10198, të dates 10 Dhjetor 2009 "Mbi sipërmarrje të investimeve kolektive".

Shoqëria vepron si Shoqëri Administruese për fondet e mëposhtme:

- Fondi me Kontribute të Përcaktuara "Fondi i Pensionit Vullnetar Raiffeisen" i aprovuar nga Autoriteti i Mbikqyrjes Financiare më 18 tetor 2010;
- "Raiffeisen Prestigj"- fond investimi i cili u aprovua nga Autoriteti i Mbikqyrjes Financiare më 13 Dhjetor 2011;
- "Raiffeisen Vision"- fond investimi i cili u aprovua nga Autoriteti i Mbikqyrjes Financiare më 30 korrik 2018
- "Raiffeisen Invest Euro"- fond investimi i cili u aprovua nga Autoriteti i Mbikqyrjes Financiare më 26 shtator 2012.
- "Raiffeisen Mix"-fond investimi i cili u aprovua nga Autoriteti i Mbikqyrjes Financiare më 23 tetor 2020.

Këshilli i Administrimit si organi qendror i Shoqërisë përbëhet nga 7 anëtarë si më poshtë:

Znj. Donalda GJORGA	Kryetare
Z. Peter ZILINEK	Zv.kryetar
Z. Erjon BALLI	Anëtar
Znj. Elona LLACI	Anëtare
Znj. Gentjana CICERI	Anëtare
Znj. Edlira KONINI	Anëtare
Znj. Alketa EMINI	Anëtare

Administratorët janë:

Znj. Edlira KONINI	Administratore e Përgjithshme
Znj Alketa EMINI	Zv/Administratore e Përgjithshme

## **2. Baza e përgatitjes**

Pasqyrat financiare janë përgatitur në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF). Pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2023 janë aprovuar nga grupi i menaxhimit të Shoqërisë më 21 mars 2024.

### **2.1 Parimi i vijimësisë**

Pasqyrat financiare të Shoqërisë janë përgatitur në bazë të parimit të vijimësisë, i cili supozon që Shoqëria do të vazhdojë veprimtarinë e saj operacionale për të paktën një periudhë prej 12 muajsh nga data e raportimit financiar. Shoqëria kryen provat e rezistencës për cdo fond të administruar prej saj, me qëllim përlllogaritjen e likuiditetit të nevojshëm në kushtet e skenarëve të përkeqësuar të tregut, nën supozimin e tërheqjes së kuotave nga 3 në 30 ditë dhe kohës së nevojshme për likuidimin e investimeve të cdo fondi.

Shoqëria vazhdon të ruajë një nivel të kënaqshëm likuiditeti si rezultat i rritjes së vlerës neto të aktiveve të fondeve Raiffeisen Pension, Prestigj dhe Raiffeisen Miks. Të gjitha fondet kanë shfaqur një normë totale të kthimit të përmirësuar gjatë vitit 2023. Ulja e kuotave ka vijuar vetëm në fondin Euro dhe fondin Vizion por në një nivel mesatar përkatësisht 12-13%, me vlerën per njësi të kuotave që tregojnë një përmirësim përkatësisht 5% dhe 12%.

Sipas provave të rezistencës, vlerësohet se fondet mund të arrijnë të përballojnë skenarët e përkeqësuar, duke qënë në përputhje me kërkesat rregullatore për likuidimet brenda afatit .

Operacioni i vazhdueshëm ushtarak në Ukrainë dhe sanksionet e lidhura me të, të synuara kundër Federatës Ruse, kanë ndikuar në ekonominë evropiane dhe globalisht. Shoqëria nuk ka ndonjë ekspozim të drejtpërdrejtë të rëndësishëm ndaj Ukrainës, Rosisë ose Bjellorusisë.

Bazuar në sa më lart dhe në rezultatet e provave të rezistencës, Drejtimi i Shoqërisë ka arritur në përfundim se nuk ka pasiguri të qenësishme në aftësinë e Shoqërisë për të vijuar aktivitetin e saj, për të ardhmen e parashikueshme, prej të paktën 12 muajsh nga data e aprovimit të këtyre pasqyrave financiare. Si rrjedhojë, Drejtimi gjykon se parimi i vijimësisë është bazë e përshtatshme në përgatitjen e këtyre pasqyrave.

## **3. Monedha funksionale dhe raportuese**

Këto pasqyra financiare janë prezantuar në Lek shqiptar ("Lek"), e cila është monedha funksionale për Shoqërinë.

### **4. Bazat e matjeve**

Këto pasqyra financiare janë përgatitur në bazë të kostos historike.

### **5. Vlerësime dhe gjykime kontabël**

Përgatitja e pasqyrave financiare kërkon që drejtimi i Shoqërisë të kryejë gjykime, çmuarje dhe supozime të cilat ndikojnë në zbatimin e politikave kontabël dhe shumave të raportuara të aktiveve dhe detyrimeve, të ardhurave dhe shpenzimeve. Rezultatet aktuale mund të ndryshojnë nga çmuarjet.

Çmuarjet dhe supozimet përkatëse rishikohen në mënyrë të vazhdueshme. Rishikimet e çmuarjeve njihen në mënyrë prospective.

#### **A. Gjykime**

Informacioni për gjykimet e bëra në aplikimin e politikave kontabël që kane efektet më të rëndësishme në vlerat e njohura në pasqyrat financiare janë të perfshira në shënimin e mëposhtëm:

- Shënimi 6(b) – njohja e të ardhurave: nëse të ardhurat janë njohur përgjatë kohës ose në një pikë në kohë

#### **B. Supozimet dhe vlerësimet e pasigurive**

Informacioni mbi vlerësimin e pasigurive të cilat kanë një ndikim të rëndësishëm në vlerën e aktiveve dhe detyrimeve të paraqitura në pasqyrat financiare përshkruhet në paragrafët në vijim:

- Shënimi 21(i) – zhvlerësimi i instrumenteve financiare: përcaktimi i të dhënave për modelin e matjes të HPK-ve, përfshirë informacionin mbi të ardhmen;

Shënimi 22: njohja dhe matja e detyrimeve të kushtëzuara: vlerësimet kryesore për mundësinë dhe sasinë e flukseve dalëse të burimeve.

## 6. Ndryshimet në politikat kontabël

### a) Standardet dhe interpretimet në fuqi në periudhën aktuale

Në vitin aktual, Shoqëria ka aplikuar një sërë ndryshimesh në Standardet e Kontabilitetit të SNRF-ve të nxjerra nga Bordi i Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit (BSNK) që janë të detyrueshëm në fuqi për periudhën raportuese që fillon më ose pas 1 janarit 2023:

- **SNRF 17 “Kontratat e sigurimit”** (publikuar më 18 maj 2017 dhe në fuqi për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2023). Adoptimi i standardit nuk pati një ndikim material në këto pasqyra financiare të veçanta.
- **Ndryshimet në SNRF 17 dhe një ndryshim në SNRF 4** (publikuar më 25 qershor 2020 dhe në fuqi për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janar 2023). Ndryshimet përfshijnë një numër sqarimesh që synojnë të lehtësojnë zbatimin e SNRF 17, të thjeshtojnë disa kërkesa të standardit dhe të tranzicionit. Ndryshimet lidhen me tetë fusha të SNRF 17 dhe ato nuk synojnë të ndryshojnë parimet themelore të standardit. Adoptimi i standardit nuk pati një ndikim material në këto pasqyra financiare të veçanta.
- **Opsioni i tranzicionit për siguruesit që zbatojnë SNRF 17 – Ndryshimet në SNRF 17** (publikuar më 9 dhjetor 2021 dhe në fuqi për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2023). Adoptimi i standardit nuk pati një ndikim material në këto pasqyra financiare të veçanta.
- **Ndryshime në SNK 1 dhe Deklarata e Praktikës 2 të SNRF:** Dhënia e informacioneve shpjeguese të politikave kontabël (publikuar më 12 shkurt 2021 dhe efektive për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2023). Adoptimi i standardit nuk pati një ndikim material në këto pasqyra financiare të veçanta.
- **Ndryshime në SNK 8: Përkufizimi i Vlerësimeve Kontabël** (publikuar më 12 shkurt 2021 dhe në fuqi për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2023). Amendamenti i SNK 8 sqaroi se si kompanitë duhet të dallojnë ndryshimet në politikat kontabël nga ndryshimet në vlerësimet kontabël. Miratimi i ndryshimeve nuk pati një ndikim material në këto pasqyra financiare të veçanta.
- **Tatimi i shtyrë në lidhje me aktivet dhe detyrimet që rrjedhin nga një transaksion i vetëm – Ndryshimet në SNK 12** (publikuar më 7 maj 2021 dhe në fuqi për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas datës 1 janar 2023). Ndryshimi nuk pati një ndikim material në këto të veçanta financiare deklaratat.

Zbatimi i ndryshimeve të mësipërme nuk pati ndikim të rëndësishëm në pasqyrat financiare të veçanta të Bankës.

### Deklaratat e reja të kontabilitetit

Në datën e autorizimit të këtyre pasqyrave financiare, standardet e reja të mëposhtme, ndryshimet në standardet ekzistuese dhe interpretimet e reja ishin në qarkullim, por ende nuk janë në fuqi. Drejtimi parashikon që të gjitha njoftimet përkatëse do të miratohen për periudhën e parë që fillon në ose pas datës efektive të publikimit. Kompania nuk pret që adoptimi i Standardeve të listuara më sipër do të ketë një ndikim material në pasqyrat financiare të Kompanisë në periudhat e ardhshme.

- **Ndryshimet në SNRF 16 Qiratë:** Detyrimi i Qirasë në një shitje dhe kthimi i qirasë (publikuar më 22 shtator 2022 dhe në fuqi për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2024).
- **Klasifikimi i pasiveve si afatshkurtëra ose afatgjata – Ndryshime në SNK 1** (fillimisht i publikuar më 23 janar 2020 dhe i ndryshuar më pas më 15 korrik 2020 dhe 31 tetor 2022, përfundimisht në fuqi për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2024).
- **Ndryshime në SNK 7 Pasqyra e Flukseve të Parasë dhe SNRF 7 Instrumentet Financiare:** Dhënia e informacioneve shpjeguese: Marrëveshjet financiare të furnizuesit (Lëshuar më 25 maj 2023). Ndryshimet nuk prekin parimet e njohjes ose të matjes, por vetëm kërkesat e zbulimit. Kërkesat e reja për dhënie informacionesh shpjeguese do të jenë efektive për periudhat vjetore të raportimit që fillojnë më ose pas datës 1 janar 2024.

Përveç nëse përshkruhet ndryshe më lart, standardet dhe interpretimet e reja nuk pritet të ndikojnë ndjeshëm në pasqyrat financiare të Bankës. Drejtimi parashikon që të gjitha njoftimet përkatëse do të miratohen për periudhën e parë që fillon ose pas datës efektive të publikimit.

## **7. Përmbledhje e politikave materiale kontabël**

Shoqëria ka zbatuar vazhdimisht politikat kontabël të mëposhtme për të gjitha periudhat e paraqitura në këto pasqyra financiare, përveç nëse përmendet ndryshe.

Për më tepër, Shoqëria miratoi Shpalosjen e Politikave Kontabël (Amendamenti i SNK 1 dhe Deklarata e Praktikës SNRF) nga 1 janari 2023. Ndryshimet kërkojnë dhënie informacione shpjeguese për politikat kontabël "materiale" dhe jo "të rëndësishme". Megjithatë ndryshimet nuk rezultuan në ndonjë ndryshim në vetë politikat kontabël, ato ndikuan në informacionin e politikave kontabël të shpalosur në raste të caktuara.”

### **a) Transaksionet në monedhe të huaj**

Transaksionet në monedhë të huaj janë konvertuar në monedhën funksionale me kursin e këmbimit në datën e transaksioneve. Aktivitetet dhe detyrimet monetare të shprehura në monedhë të huaj në datën e raportimit janë ri-konvertuar në monedhën funksionale me kursin e këmbimit në atë datë. Aktivitetet dhe detyrimet jo-monetare të shprehura në monedha të huaja që maten me vlerën e drejtë, konvertohen në monedhën funksionale në kursin e këmbimit në datën kur përcaktohet vlera e drejtë. Zërat jo-monetarë që maten në bazë të kostos historike në një monedhë të huaj janë përkthyer duke përdorur kursin e këmbimit në datën e transaksionit. Diferencat në valutë të huaj që rrjedhin nga përkthimi njihen në fitim ose humbje.

### **b) Të ardhurat**

Të ardhurat nga administrimi përfaqësojnë tarifën e menaxhimit të aktiveve dhe konsiderohet si e ardhur nga shërbimet lidhur me Fondet e Pensioneve/ Investimeve që Shoqëria ka në menaxhim. Shoqëria sillet si agjent kur siguron shërbimin e menaxhimit të aktiveve.

Tarifat e shërbimit të menaxhimit të aktiveve llogariten sipas një përqindje fikse të vlerës neto të aktiveve të menaxhuara (shih Shënimin 16 për detaje). Prandaj, kjo konsideratë është variable. Natyra e secilës prej rrjedhave të të ardhurave të Shoqërisë së rezulton në një detyrim të vetëm të performancës: menaxhimin e aktiveve. Kështu, Shoqëria nuk ka bërë gjykime të rëndësishme me alokimin e cmimit të transaksionit të detyrimit të performancës.

Tarifat e menaxhimit njihen përgjatë kohës që shërbimi sigurohet. Përkatësisht, të ardhurat njihen çdo ditë si një përqindje fikse (përqindje ditore) e vlerës neto të aktiveve për secilin nga fondet e administruara që prej një date të caktuar. Shumat janë zakonisht të pagueshme Brenda 30 ditësh duke ia ngarkuar llogarisë së fondit përkatës. Meqë të ardhurat njihen si shuma e llogaritjeve të përditshme, nuk nevojiten rregullime në fund të periudhës.

Sipas Ligjit të Fondit të Pensioneve, pjesëtarët e fondit që vendosin të tërheqin fondet përpara limitit kohor të parashkruar në ligj, i nënshtrohen penaliteteve (një % e paracaktuar e vlerës neto të aktiveve). Të ardhura nga penalitete të tilla njihen kur ndodh një tërheqje e parakohshme. Kjo e ardhur paraqitet si një rresht i vecantë në pasqyrën e fitimit/ humbjes dhe të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse nën emrin “Të ardhura nga tërheqjet”.

## **7. Përmbledhje e politikave materiale kontabël (vazhdim)**

### **c) Interesi**

#### *Norma efektive e interesit*

Të ardhurat dhe shpenzimet e interesit njihen në fitim ose humbje duke përdorur metodën e interesit efektiv. Norma efektive e interesit është norma që skanton ekzaktësisht pagesat e ardhshme të parashikuara përgjatë jetës së pritshme të instrumentit financiar me:

- Vlerën e mbetur bruto të aktivit; ose
- Koston e amortizuar të detyrimit financiar.

Kur llogaritet norma efektive e interesit për instrumentet financiare përveç aktiveve të provigjonuara, Shoqëria parashikon flukset e ardhshme duke konsideruar kushtet kontraktuale të instrumentit financiar, por jo gjithë humbjet.

Llogaritja e normës efektive të interesit përfshin kostot e transaksionit, tarifat dhe pikat e paguara ose të përfituara që janë një pjesë thelbësore e normës efektive të interesit. Kostot e transaksionit përfshijnë kostot në rritje që i atribuohen drejtpërdrejt blerjes ose emetimit të një aktivi ose detyrimi financiar.

#### *Kostoja e amortizuar dhe vlera e mbetur bruto*

Kostoja e amortizuar e një aktivi ose detyrimi financiar është shuma me të cilën ky aktiv ose detyrim matet në njohjen fillestare, minus pagesat e principalit, plus ose minus amortizimin e akumuluar duke përdorur metodën e interesit efektiv të cdo difference mes shumës fillestare të njohur dhe shumës së maturuar.

‘Vlera e mbetur bruto e një aktivi financiar’ është kosto e amortizuar e një aktivi financiar përpara rregullimit për humbjet e pritshme.

#### *Llogaritja e të ardhurave dhe shpenzimeve të interesit*

Për të llogaritur të ardhurat dhe shpenzimet e interesit, norma efektive e interesit aplikohet mbi vlerën e mbetur bruto të aktivit.

#### *Prezantimi*

Të ardhurat nga interesi prezantohen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve me koston e amortizuar të llogaritur mbi bazën e interesit efektiv.

### **d) Shpenzimet operative**

Shpenzimet operative njihen në momentin kur ndodhin.

## **7. Përmbledhje e politikave materiale kontabël (vazhdim)**

### **e) Qiraja**

#### *(i) Shoqëria si qiramarrës*

Kontratat e qirasë për zyra negociohen tipikisht për periudha 1 deri në 10 vjecare. Shoqëria nuk përfshihet në marrëveshje shitje dhe ridhënie me qira. Shoqëria vlerëson nëse një kontratë është ose përmban një qira në pikënisje të kontratës. Një qira mbart të drejtën e drejtimit te përdorimit dhe marrjes së gjithë përfitimeve ekonomike të një aktivi të identifikuar për periudhën e zgjatjes së kontratës.

Disa kontrata qiraje përmbajnë komponentë qiraje dhe jo-qiraje. Komponentët e jo-qirasë lidhen me facilitetet e shërbimit të menaxhimit. Shoqëria ia ka zgjedhur të mos i ndajë qiratë për zyra në komponentët e lartpërmendur.

#### *(ii) Matja dhe njohja e qirave si qiramarrës*

Në datën e nisjes së qirasë, Shoqëria njeh një aktiv dhe një detyrim qiraje përkatës në gjithë marrëveshjet ku është qiramarrës, përveç qirave afatshkurtra (më pak se 12 muaj) dhe qiratë me vlerë të ulët (si tableta, kompjuter personal, telefona, etj). Për këto qira, Shoqëria njeh pagesat e qirasë si shpenzim operativ me bazë lineare përgjatë kohës së qirasë.

Aktivi në përdorim matet me kosto, që përbëhet nga matja fillestare e detyrimit të qirasë, cdo kosto direkte e pësuar nga Shoqëria, një përafrim i koston për të hequr aktivin në fund të qirasë dhe cdo pagesë qiraje e bërë para datës së fillimit të qirasë.

Shoqëria e zhvlerëson aktivin me bazë linare nga data e nisjes së qirasë deri në fund të jetës së vlefshme. Shoqëria gjithashtu vlerëson aktivin për provigjon kur ka indikatorë të tillë. Në datën e fillimit, Shoqëria mat detyrimin e qirasë me vlerën aktuale të pagesave të qirasë të pakryera në atë datë, skontuar me normën e huamarrjes së Shoqërisë. Norma e huamarrjes së Shoqërisë është norma që Shoqëria do të duhet të paguante për të marrë hua të njëjtën shumë me kushte të ngjashme dhe sigur të ngjashme për të marrë një aktiv me vlerë ekuivalente.

Pagesat e qirasë të përfshira në matjen e detyrimit përbëhen nga pagesa fikse, pagesa variable të bazuara mbi një indeks ose normë, shuma që pritet të jenë të pagueshme nën një vlerë garancie dhe pagesa që lindin nga opsione të logjikshme për t'u ushtruar.

Aktivet në përdorim prezantohen me aktivet materiale në bilanc (shih Shënimin 11). Detyrimet e qirasë paraqiten në një rresht të vecantë në bilanc.

### **f) Përfitimet e punonjësve**

#### *(i) Planet e kontributeve të përcaktuara*

Detyrimet për planet e kontributeve njihen në humbje ose fitim, pasi shërbimi përfshihet në shpenzime stafi.

#### *(ii) Fondet shoqërore, të pensionit dhe shëndetit*

Shoqëria derdh contribute të detyrueshme shoqërore dhe shëndetësore në një fond të drejtuar nga shteti shqiptar. Detyrimet për këtë fond njihen në fitim ose humbje dhe përfshihen në shpenzime stafi.

#### *(iii) Leje vjetore e paguar*

Shoqëria njeh si detyrim shumë të zbritur të kostove të llogaritura për lejen vjetore, që pritet të paguhet në këmbim të shërbimit të punonjësit për periudhën e kryer.

#### *(iv) Përfitime afatshkurtra*

Përfitimet afatshkurtra të punonjësve maten në bazë jo të zbritshme dhe shpenzohen ndërkohë që sigurohet shërbimi. Njihet një provigjon për shumë që pritet të paguhet nën bonusin afatshkurtër nëse Shoqëria ka një detyrim të paguajë këtë shumë si rezultat i një shërbimi të kryer nga punonjësi në të shkuarën dhe mund të matet në mënyrë të besueshme.

## **7. Përmbledhje e politikave materiale kontabël (vazhdim)**

### **(g) Shpenzimet për tatimin e të ardhurave**

Shpenzimet për tatimin e të ardhurave përbëhen nga taksat aktuale dhe të shtyra. Njihet në fitim ose humbje përveç nëse lidhet me zëra të kapitalit ose zëra të të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse.

#### *Taksat aktuale*

Taksat aktuale përbëhen nga taksat e pagueshme ose të arkëtueshme mbi fitimin ose humbjen e tatueshme për vitin dhe rregullimet e taksave të pagueshme ose të arkëtueshme të vitit paraardhës. Shuma e taksës së pagueshme ose të arkëtueshme është përafrimi më i mirë i shumës që pritet të paguhet ose të përfitohet që reflekton sigurinë lidhur me taksat mbi të ardhurat, nëse ka.

### **(h) Instrumentat financiarë**

#### *(i) Njohja dhe matja fillestare*

Shoqëria njeh aktivet dhe detyrimet financiare përmes në datën e tregëtimit, e cila është data kur Shoqëria bëhet palë e provizionit kontraktual të instrumentit. Aktivet dhe detyrimet e tjera financiare njihen në datën kur ato krijohen. Një aktiv financiar ose detyrim financiar, në njohjen fillestare do të matet me vlerën e drejtë të tij plus, në rastin e elementëve të përcaktuar jo me vlerën e drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes, koston e transaksionit që i ngarkohet drejtpërdrejt blerjes ose emetimit.

Aktivitet financiarë, të ndryshme nga ato të përcaktuara dhe efektive si instrumenta mbrojtës, klasifikohen në kategoritë e mëposhtme:

- Me kosto të amortizuar
- Me vlerë të drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes (VDNFH).
- Me vlerë të drejtë nëpërmjet të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse (VDAGJ)

Klasifikimi përcaktohet nga:

- modeli i biznesit i njësisë ekonomike për menaxhimin e aktivitet financiar
- karakteristikat e flukseve të parasë kontraktuale të aktivitet financiar.

Të ardhurat dhe shpenzimet që lidhen me aktivet financiare që njihen në fitim ose humbje paraqiten brenda shpenzimeve financiare, të ardhurave financiare ose zërave të tjerë financiarë, me përjashtim të shpenzimeve zhvlerësimit të të arkëtueshmet tregtare të cilat përfshihen brenda shpenzimeve të tjera.

#### *(ii) Klasifikimi dhe matja e mëpasshme*

##### *Aktivitet financiarë*

Në njohjen fillestare, aktivi financiar klasifikohet si i matur me koston e amortizuar ose me VDAGJ. Aktivitet financiarë nuk riklasifikohen pas njohjes fillestare, përveç nëse Shoqëria ndryshon modelin e saj të biznesit për menaxhimin e aktiveve financiare, në këtë rast të gjitha aktivitet financiarë të ndikuara riklasifikohen në ditën e parë të periudhës së parë raportuese pas ndryshimit në modelin e biznesit.

##### *Vlerësimi i modelit të biznesit*

Shoqëria vlerëson objektivat e modeleve të biznesit sipas të cilave menaxhohet një aktiv në nivel portofoli sepse kjo reflekton mënyrën më të mirë sesi menaxhohet biznesi dhe si informacioni i paraqitet drejtitimit. Informacioni i vlerësuar përfshin:

- politikat dhe objektivat e përcaktuara të portofolit dhe zbatimi i tyre në praktikë. Në veçanti, nëse strategjia e drejtitimit fokusohet në përfitimin e të ardhurave kontraktuale nga interesi, mbajtjen e një profili të veçantë të normës së interesit, përputhjen e kohëzgjatjes së aktiveve financiare me kohëzgjatjen e detyrimeve që financojnë këto aktive ose realizimin e flukseve të parasë nëpërmjet shitjes së aktiveve;
  - si vlerësohet performanca e portofolit dhe si i raportohet kjo performancë e drejtitimit;
  - rreziqet që ndikojnë në performancën e modeleve të biznesit (dhe të aktiveve financiare të mbajtura brenda këtij modeli biznesi) dhe si menaxhohen këto rreziqe;
  - si kompensohen menaxherët e portofoleve - p.sh. nëse kompensimi bazohet në vlerën e drejtë të aktiveve të menaxhuara ose në flukset të parasë kontraktuale të mbledhura; dhe
  - frekuencën, volumin dhe kohën e shitjeve për periudhat e kaluara, arsyet e të tilla shitjeve dhe pritshmëritë për aktivitetin e ardhshëm të shitjeve. Megjithatë, informacioni mbi shitjet nuk merret parasysh i izoluar, por si pjesë e vlerësimit të përgjithshëm se si arrihen nga Shoqëria objektivat e përcaktuara për menaxhimin e aktiveve financiare dhe si realizohen flukset të parave të ardhshme.
-



## **7. Përmbledhje e politikave materiale kontabël (vazhdim)**

### **h) Instrumentat financiarë (vazhdim)**

Transferimi i aktiveve financiare me palë të treta me anë të transaksioneve që nuk i plotësojnë kushtet për çregjistrim, nuk konsiderohen shitje për këtë qëllim, në përputhje me njohjen në vazhdimësi të aktiveve të Shoqërisë. Shoqëria ka përcaktuar se ka një model biznesi që përfshin investimet në letrat me vlerë dhe investimet në fondet e investimeve të palistruara. Këto mjete financiare menaxhohen dhe performanca e tyre vlerësohet, në bazë të vlerës së drejtë, me shitjet e shpeshta që ndodhin.

*Vlerësimi nëse flukset të parave kontraktuale janë vetëm pagesa e principalit dhe interesit ("VPPI")*

Për qëllim të këtij vlerësimi, 'principal' është vlera e drejtë e aktivit financiar në njohjen fillestare. 'Interesi' është shpërblimi për vlerën në kohë të parasë dhe për rrezikun e kredisë të lidhur me shumën e principalit të pashlyer gjatë një periudhe kohore të caktuar, për rreziqet dhe kostot e tjera bazë të kreditimit (p.sh. rreziku i likuiditetit dhe kostot administrative), duke përfshirë gjithashtu marzhin e fitimit.

Për të vlerësuar nëse flukset e parave kontraktuale janë pagesa vetëm të principalit dhe interesit, Shoqëria merr parasysh kushtet kontraktuale të instrumentit. Kjo përfshin vlerësimin nëse një aktiv financiar përmban një element kontraktual që mund të ndryshojë kohën ose shumën e flukseve të parave kontraktuale në mënyrë të tillë që nuk plotëson kushtin. Gjatë vlerësimit, Shoqëria konsideron:

- ngjarje të kushtëzuara që mund të ndryshojnë kohën dhe shumën e flukseve të parasë;
- kushte që mund të ndryshojnë normën kontraktuale të interesit, përfshirë normat e ndryshueshme;
- parapagimet dhe kushtet e shtyrjes; dhe
- kushtet që kufizojnë pretendimet e Shoqërisë për flukset e parave nga aktive të caktuara (tipare të pakthyeshme)

Një tipar parapagimi është në përputhje me kushtin e pagesës vetëm për principalin dhe interesin nëse shuma e parapaguar në thelb paraqet shumën e papaguara të principalit dhe të interesit mbi shumën e principalit të papaguar, të cilat mund të përfshijnë kompensim të arsyeshëm shtesë për ndërprerjen e hershme të kontratës. Gjithashtu, për një aktiv financiar të blerë me zbritje apo me prim mbi shumën kontraktuale, një tipar që lejon ose kërkon parapagim për një shumë që në thelb paraqet shumën kontraktuale plus interesa kontraktuale të përlogaritur (por të papaguar), interes kontraktual (që mund të përfshijë dhe shpërblim për përfundim të parakohshëm) trajtohet si të jetë në përputhje me këtë kriter nëse vlera e drejtë e tiparit të parapagimit është e parëndësishme në njohjen fillestare.

*Aktivet financiare- Klasifikimi, matja e mëpasshme dhe fitimet dhe humbjet*

Shoqëria njeh Aktivet e veta financiare në Pasqyrën e Pozicionit Financiar kur njësia bëhet palë e provizionimit kontraktual të instrumentit gjatë blerjes së rregullt të aktivit. Mënyra e rregullt e blerjes apo shitjes së aktivit financiar regjistrohet dhe c'rrregjistrohet, si e zbatueshme, duke përdorur datën kontabël të shlyerjes. Data e shlyerjes është data në të cilën aktivi dorëzohet nga ose tek një njësi. Data kontabël e shlyerjesi referohet (a) njohjes së një aktivit në ditën e marrë nga njësia dhe (b) c'rrregjistrimi i një aktivit dhe njohja e cdo fitimi ose humbjeje mbi nxjerrjen në ditën gjatë së cilës është dorëzuar nga njësia. Kur data kontabël e shlyerjes aplikohet, njësia llogarit për cdo ndryshim në vlerën e drejtë të aktivit

që pritet të merret gjatë periudhës nga data e tregëtimit deri në datën e shlyerjes në të njëjtën mënyrë sic llogaritet për aktivin e blerë. E thënë ndryshe, ndryshimi në vlerëne drejtë nuk njihet për aktivet e matura me kosto ose kosto të amortizuara; njihet në fitim ose humbje për aktivet e klasifikuara si aktive

financiare me vlerën e drejtë përmes fitimit ose humbjes; dhe njihet tek të ardhurat e tjera gjithëpërfshirëse për aktivet e klasifikuara si të vlefshme për shitje.

*Detyrimet financiare - Klasifikimi, matja e mëpasshme dhe fitimet dhe humbjet*

Detyrimet financiare klasifikoheshin si të matura me koston e amortizuar dhe pas njohjes fillestare ato mateshin me kosto të amortizuar duke përdorur metodën e interesit efektiv. Shpenzimet e interesit dhe fitimet dhe humbjet nga kursi i këmbimit dhe zhvlerësimi njiheshin në fitim ose humbje. Çdo fitim ose humbje në momentin e çregjistrimit, njihet në fitim ose në humbje.

## **7. Përmbledhje e politikave materiale kontabël (vazhdim)**

### **h) Instrumentat financiarë (vazhdim)**

#### *(iii) Çregjistrimi*

##### *Aktivët financiarë*

Shoqëria çregjistron një aktiv financiar kur të drejtat kontraktuale mbi flukset e parasë nga aktivi financiar kanë skaduar, ose kur transferon të drejtat për të marrë flukse kontraktuale në një transaksion me anë të së cilit të gjithë rreziqet dhe përfitimet e pronësisë së aktivit financiar janë transferuar, ose me anë të së cilit Shoqëria nuk transferon as mbart të gjitha rreziqet dhe përfitimet e pronësisë dhe ajo nuk mban kontrollin e aktivit financiar.

Shoqëria bëhet pjesë e transaksioneve me anë të të cilave transferon aktivet e njohura në pasqyrën e pozicionit financiar por ruan pjesën më të madhe ose të gjitha rreziqet dhe përfitimet e aktiveve të transferuara. Në të tilla raste, aktivet e transferuara nuk çregjistrohen.

##### *Detyrimet financiare*

Shoqëria çregjistron një detyrim financiar kur detyrimet e saj kontraktuale shkarkohen, anulohen ose skadojnë. Shoqëria gjithashtu çregjistron një detyrim financiar kur kushtet e tij kontraktuale ndryshojnë dhe flukset e parave të detyrimit të modifikuar ndryshojnë thelbësisht. Në këtë rast njihet, një detyrim i ri financiar i bazuar në kushtet e modifikuara, njihet me vlerën e drejtë.

Në çregjistrimin e një detyrimi financiar, diferenca midis vlerës kontabël neto dhe shumës së paguar (duke përfshirë çdo aktiv financiar të transferuar apo detyrime të marra) njihet në fitim ose humbje.

#### *(iv) Kompensimi (netimi)*

Aktivët dhe detyrimet financiare netohen dhe shuma neto paraqitet në pasqyrën e pozicionit financiar atëherë dhe vetëm atëherë kur Shoqëria ka të drejtë ligjore për të shlyer shumën dhe ka për qëllim të shlyejë ato në baza neto ose të realizojë aktivin dhe të shlyejë detyrimin në të njëjtën kohë.

#### *(v) Modifikimi i aktiveve dhe detyrimeve financiare*

##### *Aktivët financiarë*

Nëse kushtet e një aktivi financiar modifikohen, Shoqëria vlerëson nëse flukset e parasë të aktivit të modifikuar janë thelbësisht të ndryshme.

Nëse flukset e parasë janë thelbësisht të ndryshme, atëherë të drejtat kontraktuale për flukset e parasë nga aktivi financiar fillestar konsiderohen se kanë skaduar. Në këtë rast, aktivi financiar origjinal çregjistrohet (shih (iii)) dhe një aktiv financiar i ri njihet me vlerën e drejtë.

Nëse flukset e parasë të aktivit të modifikuar, të matur me kosto të amortizuar nuk janë thelbësisht të ndryshme, atëherë modifikimi nuk rezulton në çregjistrimin e aktivit financiar. Në këtë rast, Shoqëria rillogarit vlerën kontabël bruto të aktivit financiar dhe njeh shumën që vjen nga rregullimi i vlerës kontabël bruto si fitim ose humbje nga modifikimi në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Nëse një modifikim i tillë kryhet për shkak të vështirësive financiare të huamarrësit (shih (vii)), atëherë fitimi ose humbja paraqiten së bashku me humbjet nga zhvlerësimi. Në raste të tjera, ajo paraqitet si e ardhur nga interesi (shih 8(c)).

##### *Detyrimet financiare*

Shoqëria çregjistron një detyrim financiar, kur kushtet e tij janë modifikuar dhe flukset e parasë të tyre janë thelbësisht të ndryshme. Në këtë rast njihet një detyrim i ri financiar me vlerë të drejtë bazuar

#### *(v) Modifikimi i aktiveve dhe detyrimeve financiare*

në kushtet e modifikuara. Diferenca midis vlerës kontabël të aktivit që çregjistrohet dhe detyrimit të ri financiar me terma të modifikuara njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Nëse modifikimi i një detyrimi financiar nuk njihet si çregjistrim, atëherë kostoja e amortizuar e detyrimit rillogaritet duke skontuar flukset e parasë të modifikuara me normën fillestare të interesit efektiv dhe fitimi ose humbja që rezulton njihet në fitim ose humbje.

## **7. Përmbledhje e politikave materiale kontabël (vazhdim)**

### **h) Instrumentat financiarë (vazhdim)**

#### *(iii) Matja e vlerës së drejtë*

‘Vlera e drejtë’ është çmimi që do të arkëtohej nga shitja e një aktivi ose që do të paguhej për të transferuar një detyrim në një transaksion të rregullt midis pjesëmarrësve të tregut, në datën e matjes në një treg kryesor ose, në mungesë të tij, në tregun më të favorshëm tek i cili Shoqëria ka qasje në atë datë. Vlera e drejtë e një pasivi pasqyron rrezikun e tij të mosekzekutimit.

Dëshmia më e mirë e vlerës së drejtë të një instrumenti financiar në njohjen fillestare është normalisht çmimi i transaksionit - dmth. Vlera e drejtë e shumës së dhënë ose të marrë.

Kur është e mundur, Shoqëria mat vlerën e drejtë të një instrumenti duke përdorur çmimin e kuotuar në një treg aktiv për atë instrument. Një treg quhet “aktiv”, në qoftë se transaksionet për aktivin ose detyrimin ndodhin me frekuencë dhe vëllim të mjaftueshëm për të siguruar informacion mbi çmimet në vazhdimësi.

Nëse nuk disponohet një kuotim çmimi në një treg aktiv, atëherë Shoqëria përdor teknika vlerësimi që maksimizojnë përdorimin e të dhënave të vrojtueshme dhe minimizojnë përdorimin e të dhënave jo të vrojtueshme. Teknika e zgjedhur përmbledh të gjithë faktorët që pjesëmarrësit e tregut do të marrin në konsideratë për përcaktimin e çmimit të një transaksioni.

Shoqëria njeh transferimin ndërmjet niveleve të hierarkisë së vlerës së drejtë në fund të periudhës raportuese në të cilën ka ndodhur ndryshimi.

#### *(vii) Zhvlerësimi*

Shoqëria njeh një zbritje për HPK për aktivet financiare të njohura me koston e amortizuar dhe e mat zbritjen në një shumë të barabartë me totalin e HPK përgjatë jetës së aktivitetit, përveç letrave me vlerë për të cilat llogariten me HPK 12-mujore.

Shoqëria e konsideron një aktiv financiar në rrezik mosshlyerje kur:

- kundërpartia ka pak gjasa të paguajë detyrimet e plota ndaj Shoqërisë pa masa shtrënguese nga ana e Shoqërisë siç është realizimi i garancisë (nëse ka një të tillë) ose;
- pagesat për aktivin financiar janë vonuar më tepër se 90 ditë.

HPK-të 12-mujore janë ato pjesë të HPK-ve që rezultojnë nga ngjarjet e dështimit, që janë të mundshme të ndodhin brenda 12 muajve nga data e raportimit. Instrumentet financiare për të cilat njihet HPK 12-mujore referohen si ‘Instrumente financiare në Fazën 1’.

HPK përgjatë gjithë jetës së aktivitetit janë HPK që rezultojnë nga ngjarjet që mund të ndodhin gjatë jetës së pritshme të një instrumenti financiar. Periudha maksimale e konsideruar gjatë vlerësimit të HPK është periudha maksimale kontraktuale gjatë së cilës Shoqëria është e ekspozuar ndaj rrezikut të kredisë.

#### *Matja e HPK*

HPK maten si mesatare e ponderuar sipas probabilitetit të ndodhjes së humbjeve të kredisë. Humbjet kreditore janë vlera aktuale e diferencave në flukset e parasë (diferenca mes flukseve të parave që duhet t’i paguhet Shoqërisë në përputhje me kontratën dhe flukseve të parave që Shoqëria pret të marrë).

HPK skontohen duke përdorur normën efektive të aktivitetit financiar.

#### *Aktivitetet financiare të zhvlerësuar*

Në çdo datë raportimi, Shoqëria vlerëson nëse aktivet financiare të matura me koston e amortizuar janë aktive financiare me kredit të zhvlerësuar. Një aktiv financiar konsiderohet me kredit të zhvlerësuar kur ka ndodhur një ose më shumë ngjarje që kanë një ndikim të dëmshëm në flukset e parasë të ardhshme të vlerësuar të aktivitetit financiar. Dëshmia se një aktiv financiar shfaq kredit të zhvlerësuar përfshin të dhënat e mëposhtme të vrojtueshme:

- vështirësi të konsiderueshme financiare të debitorit;
- shkelje të kontratës si dështimi ose mospagimi në afat;
- mundësinë që debitori të hyjë në falimentim ose ndonjë riorganizim tjetër financiar; dhe
- zhdukjen e një tregu aktiv për një letër me vlerë për shkak të vështirësive financiare.

Në kryerjen e vlerësimit nëse një investim në letra me vlerë është me kredit të zhvlerësuar, Shoqëria konsideron faktorët e mëposhtëm:

- Vlerësimin e tregut për cilësinë e kreditit, siç pasqyrohet në normat e kthimit të obligacioneve;
  - Aftësinë e vendit për të hyrë në tregjet e kapitalit për emetimin e borxhit të ri;
-

## **7. Përmbledhje e politikave materiale kontabël (vazhdim)**

### **h) Instrumentat financiarë (vazhdim)**

- Mundësinë e ristrukturimit të borxhit, duke rezultuar në humbje për mbajtësit, nëpërmjet faljes vullnetare ose të detyrueshme të borxhit; dhe
- Mekanizmat ndërkombëtarë të mbështetjes që ekzistojnë për të siguruar mbështetjen e nevojshme si 'huadhënës i fundit në radhë' për atë vend, si dhe qëllimin e reflektuar në deklaratat publike, të qeverive dhe agjencive të këtyre vendeve për përdorimin e mekanizmave të tillë. Kjo përfshin një vlerësim të thellësisë së këtyre mekanizmave dhe pavarësisht nga qëllimi politik nëse ka kapacitet për të përmbushur kriteret e kërkuara

*Paraqitja e provizionit për HPK në pasqyrën e pozicionit financiar*

Humbjet për aktivet financiare të matura me koston e amortizuar zbriten nga vlera kontabël bruto e aktiveve.

*(viii) Fshirja*

Vlera kontabël bruto e një aktivi financiar fshihet kur Shoqëria nuk ka pritshmëri për rikuperimin e plotë ose të pjesshëm të aktivitetit financiar.

### **i) Paraja dhe ekuivalentët e saj**

Paraja dhe ekuivalentët e saj përfshijnë aktive financiare mjaft likuidë me maturitet tre muaj ose më pak nga data e blerjes, të cilat janë subjekt i një risku jo të rëndësishëm të ndryshimeve në vlerën e drejtë, dhe përdoren nga Shoqëria për menaxhimin e angazhimeve afatshkurtra.

### **(j) Aktivet materiale**

*Njohja dhe matja*

Zërat e aktiveve materiale maten me kosto minus amortizimin e akumuluar dhe humbjet nga provigjonimi, nëse ka.

*Kostot pasuese*

Kostoja e zëvendësimit të një pjese të aktivitetit material njihet në vlerën e mbetur të zërit nëse është e mundur që përfitimet e ardhshme ekonomike do t'i rrjedhin Shoqërisë dhe kostot mund të maten në mënyrë të besueshme. Vlera e mbetur e pjesës së zëvendësuar rregjistrohet. Kostot e shërbimit të përditshëm të aktiveve materiale njihen në fitim ose humbje.

*Amortizimi*

Amortizimi njihet në fitim ose humbje duke përdorur metodën e reduktimit të balancës. Normat e amortizimit vjetor janë si në vijim: Pajisje zyre: 20%; Pajisje IT: 25%; Mjete: 20%.

Amortizimi llogaritet duke aplikuar normën e amortizimit përkatës mbi balancën hapëse të aktivitetit në vitin e dhënë financiar. Nëse aktivet shtohen në kategori gjatë vitit financiar, amortizimi llogaritet për muajt e mbetur të vitit.

### **k) Aktivet jomateriale**

Aktivitetet jomateriale të blera nga Shoqëria njihen me koston minus amortizimin e akumuluar dhe humbjet e akumuluar nga zhvlerësimi.

Shpenzimet e mëtejshme mbi aktivitetet jomateriale kapitalizohen vetëm kur rrisin përfitimet ekonomike të ardhshme. Të gjithë zërat e tjerë janë shpenzime.

Amortizimi njihet në fitim ose humbje duke përdorur metodën e reduktimit të balancës. Norma e amortizimit vjetor është 25%.

**Raiffeisen INVEST – Shoqëri Administruese e Fondeve të Pensionit dhe Sipërmarrjeve të Investimeve Kolektive sh.a.**

Shënimet shpjeguese të pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2023  
(të gjitha vlerat janë në Lek, përveçse kur është shprehur ndryshe)

**8. Paraja dhe ekuivalentët e saj**

Paraja dhe ekuivalentët e saj përbëhen nga llogari rrjedhëse të mbajtura në Banka vendase dhe të detajuara si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2023</u>	<u>31 dhjetor 2022</u>
Llogari në Bank	2,438,209	27,866,821
Depozita në lek me maturim me pak se 3 muaj	541,035,616	520,673,151
	<u>543,473,825</u>	<u>548,539,972</u>

Në datë 31 dhjetor 2023 dhe 2022 depozitat janë si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2023</u>	<u>31 dhjetor 2022</u>
Data e vendosjes	04 dhjetor 2023	05 dhjetor 2022
Data e maturimit	04 janar 2024	05 janar 2023
Norma e interesit	2.50%	1.75%

Depozitat dhe llogaritë afatshkurtra mbahen në Raiffeisen Bank Albania sha (kompania mëmë). Shoqëria nuk llogarit Humbjet e Pritshme nga Kredia, pasi periudha e maturimit është deri në një muaj dhe efekti është jomaterial.

**9. Llogari të arkëtueshme nga fondet**

Shumat e arkëtueshme nga fondet i përkasin komisioneve të administrimit për muajin dhjetor të pagueshme nga secili prej Fondeve nën Administrimin e Shoqërisë, penaliteteve për tërheqje të parakohshme nga Fondi i Pensionit Vullnetar si dhe detyrimet për Auditorin e jashtëm dhe janë si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2023</u>	<u>31 dhjetor 2022</u>
Të arkëtueshme nga fondi i Investimit Prestigj	30,107,958	26,287,454
Të arkëtueshme nga fondi i Investimit Vizion	8,670,214	9,455,032
Të arkëtueshme nga fondi i Investimit EURO	3,683,223	4,374,087
Të arkëtueshme nga fondi i Pensionit	1,766,080	1,535,407
Të arkëtueshme nga fondi i Investimit Prestigj (Audit)	1,236,576	
Të arkëtueshme nga fondi i Investimit EURO (Audit)	1,047,245	
Të arkëtueshme nga fondi i Investimit Vizion (Audit)	829,068	
Të arkëtueshme nga fondi i Investimit Miks	291,577	274,154
Të arkëtueshme nga fondi i Investimit Miks (Audit)	233,964	
Të arkëtueshme nga fondi i Pensionit ( penalitete)	27,493	2,051,898
	<u>47,893,399</u>	<u>43,978,033</u>

**10. Investime të mbajtura deri në maturim**

Investime të mbajtura deri në maturim janë të detajuara si mëposhtë:

	<u>31 dhjetor 2023</u>	<u>31 dhjetor 2022</u>
Vlera nominale	20,000,000	22,000,000
Interesi i përlllogaritur	350,000	226,722
Skonto/Prim i paamortizuar	198,848	
	<u>20,548,848</u>	<u>22,226,722</u>

Investimet përbëhen obligacion 3-vjecare në Lek të emtuar nga Qeveria e Republikës së Shqipërisë me normë kuponit 5.00%. Kuponit paguhet cdo 6 muaj për cdo obligacion.

**Raiffeisen INVEST – Shoqëri Administruese e Fondeve të Pensionit dhe Sipërmarrjeve të Investimeve Kolektive sh.a.**

Shënimet shpjeguese të pasqyrave financiare për vitin e mbylltur më 31 dhjetor 2023  
(të gjitha vlerat janë në Lek, përveçse kur është shprehur ndryshe)

**10. Investime të mbajtura deri në maturim (vazhdim)**

	Vlera nominale	Skonto/Prim i paamortizuar	Interesa të përlllogaritura	Vlera kontabël
Obligacione qeveritare	20,000,000	198,848	350,000	20,548,848
<b>Më 31 dhjetor 2023</b>	<b>20,000,000</b>	<b>198,848</b>	<b>350,000</b>	<b>20,548,848</b>

  

	Vlera nominale	Skonto/Prim i paamortizuar	Interesa të përlllogaritura	Vlera kontabël
Obligacione qeveritare	22,000,000	-	226,722	22,226,722
<b>Më 31 dhjetor 2022</b>	<b>22,000,000</b>	<b>-</b>	<b>226,722</b>	<b>22,226,722</b>

Lëvizjet në vlerat nominale të investimeve të mbajtura deri në maturim paraqiten si me poshtë:

	<u>31 dhjetor 2023</u>	<u>31 dhjetor 2022</u>
Më 1 janar	22,000,000	22,000,000
Të blera gjatë vitit	20,000,000	-
Të maturuara gjatë vitit	(22,000,000)	-
	<u><b>20,000,000</b></u>	<u><b>22,000,000</b></u>

**Raiffeisen INVEST – Shoqëri Administruese e Fondeve të Pensionit dhe Sipërmarrjeve të Investimeve Kolektive sh.a.**

Shënimet shpjeguese të pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2023

(të gjitha vlerat janë në Lek, përveçse kur është shprehur ndryshe)

**11. Aktive afatgjata materiale**

<i>Kosto</i>	Automjete	Pajisje zyre dhe informatike	E drejtë përdorimi e asetit	Totali
<b>Gjendja më 1 janar 2022</b>	<b>12,042,093</b>	<b>21,231,210</b>	<b>28,552,062</b>	<b>61,825,365</b>
Shtesa		1,055,956	-	1,055,956
Pakesime				
<b>Gjendja më 31 dhjetor 2022</b>	<b>12,042,093</b>	<b>22,287,166</b>	<b>28,552,062</b>	<b>62,881,321</b>
Shtesa	2,856,870	204,980	-	3,061,850
Pakesime				-
<b>Gjendja më 31 dhjetor 2023</b>	<b>14,898,963</b>	<b>22,492,146</b>	<b>28,552,062</b>	<b>65,943,171</b>
<i>Zhvlerësimi i akumuluar</i>				
<b>Gjendja më 1 janar 2022</b>	<b>9,284,264</b>	<b>13,904,026</b>	<b>1,427,603</b>	<b>24,615,893</b>
Shpenzimi i viti	551,448	1,760,713	2,855,106	5,167,267
<b>Gjendja më 31 dhjetor 2022</b>	<b>9,835,712</b>	<b>15,664,739</b>	<b>4,282,709</b>	<b>29,783,160</b>
Shpenzimi i viti	2,301,610	1,538,906	2,855,204	6,695,720
<b>Gjendja më 31 dhjetor 2023</b>	<b>12,137,322</b>	<b>17,203,645</b>	<b>7,137,913</b>	<b>36,478,880</b>
<b>Vlera kontabel</b>				
<b>Më 1 Janar 2022</b>	<b>2,757,829</b>	<b>7,327,184</b>	<b>28,552,062</b>	<b>37,209,472</b>
<b>Më 31 dhjetor 2022</b>	<b>2,206,381</b>	<b>6,622,426</b>	<b>24,269,353</b>	<b>33,098,161</b>
<b>Më 31 dhjetor 2023</b>	<b>2,761,641</b>	<b>5,288,500</b>	<b>21,414,149</b>	<b>29,464,291</b>

Më 31 dhjetor 2023 dhe 2022 nuk ka aktive afatgjata materiale të vendosura si kolateral për kredi afatgjata ose afatshkurtra.

**Raiffeisen INVEST – Shoqëri Administruese e Fondeve të Pensionit dhe Sipërmarrjeve të Investimeve Kolektive sh.a.**

Shënimet shpjeguese të pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2023  
(të gjitha vlerat janë në Lek, përveçse kur është shprehur ndryshe)

**12. Aktive afatgjata jomateriale**

	Programe Kompjuterike	Totali
<i>Kosto</i>		
<b>Gjendja më 1 janar 2022</b>	<b>33,964,142</b>	<b>33,964,142</b>
Shtesa	3,124,174	3,124,174
Pakesime	(135,692)	(135,692)
<b>Gjendja më 31 dhjetor 2022</b>	<b>36,952,625</b>	<b>36,952,625</b>
Shtesa	3,834,180	3,834,180
<b>Gjendja më 31 dhjetor 2023</b>	<b>40,786,805</b>	<b>40,786,805</b>
 <i>Zhvlerësimi i akumuluar</i>		
<b>Gjendja më 1 janar 2022</b>	<b>23,307,485</b>	<b>23,307,485</b>
Shpenzimi i vitit	3,317,263	3,317,263
Pakesime	(135,692)	(135,692)
<b>Gjendja më 31 dhjetor 2022</b>	<b>26,489,056</b>	<b>26,489,056</b>
Shpenzimi i vitit	2,627,201	2,627,201
<b>Gjendja më 31 dhjetor 2023</b>	<b>29,116,257</b>	<b>29,116,257</b>
<b>Vlera kontabël</b>		
<b>Më 1 janar 2022</b>	<b>10,656,657</b>	<b>10,656,657</b>
<b>Më 31 dhjetor 2022</b>	<b>10,463,569</b>	<b>10,463,569</b>
<b>Më 31 dhjetor 2023</b>	<b>11,670,548</b>	<b>11,670,548</b>

**13. Detyrime të tjera**

Detyrime të tjera më 31 dhjetor 2023 dhe 2022, lidhur me aktivitetin operativ të Shoqërisë paraqiten si më poshtë:

	31 dhjetor 2023	31 dhjetor 2022
Detyrime per sponsorizime	14,141,791	18,103,785
Bonus i akumuluar për punonjësit	4,829,147	4,940,805
Shpenzime të përlllogaritura auditimi	2,759,477	-
Detyrime për sigurimet shoqërore	708,345	576,148
Detyrime për tatimin mbi të ardhurat personale	548,334	562,037
Furnitorë	414,975	6,136,264
Detyrime për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare	173,331	151,118
Detyrime për Banken Kujdestare	76,553	66,461
Detyrime RBAL	-	-
Të tjera	2,531,969	1,631,181
<b>Totali</b>	<b>26,183,921</b>	<b>32,167,798</b>

Detyrimet për sponsorizimet përfaqësojnë kontratat e firmosura për aktivitete të ndryshme sponsorizimi në kuadrin e përkushtimit të Shoqërisë ndaj përgjegjësive sociale, të cilat janë firmosur në 2023, por janë ende të papaguara në 31 dhjetor. Shoqëria paguan detyrimet për sponsorizime bazuar në dokumentat për punët e performuara. Në fund të vitit 2023 disa kompani e kishin të pamundur të paraqisnin dokumenta justifikuese.



**Raiffeisen INVEST – Shoqëri Administruese e Fondeve të Pensionit dhe Sipërmarrjeve të Investimeve Kolektive sh.a.**

Shënimet shpjeguese të pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2023  
(të gjitha vlerat janë në Lek, përveçse kur është shprehur ndryshe)

**14. Detyrimet e qirasë**

	<u>31 dhjetor 2023</u>	<u>31 dhjetor 2022</u>
<b>Gjendja në 1 janar</b>	<b>24,243,199</b>	<b>27,224,272</b>
Shtesa		
Shpenzime interesi	363,323	353,055
Pagesa qiraje	(2,951,284)	(2,951,284)
Efkti i përkthimit	(108,460)	(382,844)
<b>Gjendja në 31 dhjetor</b>	<b>21,546,778</b>	<b>24,243,199</b>
Korrente	2,892,366	2,892,366
Jo-korrente	18,654,412	21,350,833
<b>Totali</b>	<b>21,546,778</b>	<b>24,243,199</b>

Shumat e mëposhtëme janë shumat e paraqitura në fitim dhe humbje:

	<u>31 dhjetor 2023</u>	<u>31 dhjetor 2022</u>
Shpenzim amortizimi i të drejtës së përdorimit	2,855,204	2,855,106
Shpenzim interesi detyrim qiraje	363,323	353,055
<b>Totali</b>	<b>3,218,527</b>	<b>3,208,161</b>

Shoqëria kishte dalje të flukseve të parasë për qira of LEK 2,762,470.88 në 2023 (LEK 2,951,284 në 2022).

*Pagesa qiraje të ardhshme*

Më 31 dhjetor, pagesat e ardhshme të qirasë nën qira të cilat nuk mund të anulohen ishin të pagueshme si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2023</u>	<u>31 dhjetor 2022</u>
Më pak se 1 vit	2,855,204	2,855,204
1-5 vite	11,420,815	11,420,815
Më shumë se 5 vite	7,270,759	9,967,180
<b>Totali</b>	<b>21,546,778</b>	<b>24,243,199</b>

Shih shënimin 20 (i) për pagesat e qirasë jo të zbritshme.

## **Raiffeisen INVEST – Shoqëri Administruese e Fondeve të Pensionit dhe Sipërmarrjeve të Investimeve Kolektive sh.a.**

Shënimet shpjeguese të pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2023  
(të gjitha vlerat janë në Lek, përveçse kur është shprehur ndryshe)

### **15. Kapitali aksionar**

Me 31 dhjetor 2023 dhe 2022, kapitali aksionar i regjistruar është 90,000,000 Lek i përbërë nga 12,857 aksione me vlerë nominale prej 7,000.08 Lek/aksion. Aksioneri i vetëm i Shoqërisë është Raiffeisen Bank sh.a. dhe aksioneri përfundimtar është Raiffeisen Bank International AG me seli në Vienë, Austri.

Referuar rezervës ligjore, bazuar në ligjin nr. 9901 datë 14 prill 2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë e tregtare” si dhe statutin e Shoqërisë, Shoqëria mban një rezervë ligjore dhe transferon cdo vit 5% te fitimit neto të realizuar në vitin financiar paraardhës derisa shumta të arrijë 10% të vlerës së kapitalit. Duke qënë se rezerva ligjore ka arritur nivelin prej 10% të vlerës së kapitalit, nuk ka patur ndryshim të rezervës ligjore gjatë vitit 2022. Përdorimi i rezervave ligjore është në vullnetin e aksionereve të Shoqërisë.

Shoqëria menaxhon strukturën e kapitalit dhe si rezultat i ndryshimeve në kushtet ekonomike bën ndryshimet përkatëse. Për të mbajtur strukturën e duhur të kapitalit, Shoqëria mund të ndryshojë pagesat e dividendit ndaj aksionerëve ose t’u kthejë kapitalin aksionerëve. Gjatë vitit të mbyllur më 31 dhjetor 2023 dhe atij të mbyllur më 31 dhjetor 2022, nuk janë bërë ndryshime në objektivat, rregullat dhe proceset në fuqi në këtë fushë.

Objektivi kryesor i menaxhimit të kapitalit të Shoqërisë është të mbajë raporte të sigurta të kapitalit që do të mbështesnin aktivitetin operativ të Shoqërisë dhe do të rrisnin vlerën për aksionerët e saj, duke iu përmbajtur kërkesave të kapitalit të kërkuar me ligj.

Shoqëria duhet t’i përmbahet kërkesave të kapitalit në përputhje me Rregulloren nr. 132 “Mbi llogaritjen e formës dhe shumës minimale të fondeve të veta të detyrueshme për shoqëritë e administrimit të fondeve”, 30 shtator 2020. Më 31 dhjetor 2023, minimumi i kërkuar i kapitalit duhet të jetë 18,464,848 ALL, kriter ky i përmbushur nga Shoqëria (kapitali ka shumën ALL 90,000,000, përjashtuar fitimin neto për 2023 dhe fitimin e pashpërndarë).

Për të marrë vendime për shpërndarjen e fitimit, Shoqëria performon aktivitetet e mëposhtëme vendimtare për të formuar politikën e dividendit:

- Monitoron konformitetin me kërkesat e kapitalit,
- Llogarit nevojat shtesë për kapital në perspektivën e 12 muajve nga momenti i aprovimit të pasqyrave financiare, në mënyrë që pagesa e dividendit nga Shoqëria të mos ndikojë përmbushjen e kriterëve të kapitalit në muajt pasardhës.

### **16. Tarifa e administrimit të Fondeve**

Tarifa e administrimit të Fondeve për vitin që mbyllet më 31 dhjetor 2023 dhe 31 dhjetor 2022 detajohet si mëposhtë:

	<u>31 dhjetor 2023</u>	<u>31 dhjetor 2022</u>
Raiffeisen Prestigj	324,723,169	467,700,681
Raiffeisen Vizion	106,710,724	178,647,423
Raiffeisen Invest Euro	44,801,950	76,752,116
Fondi i Pensionit Vullnetar Raiffeisen	19,503,857	16,896,137
Raiffeisen Miks	3,167,519	5,185,574
	<u>498,907,219</u>	<u>745,181,931</u>

Të ardhurat e administrimit të Fondeve llogariten mbi Vlerën Neto të Aktiveve ditore për secilin fond, bazuar në tarifën e përcaktuara, të detajuara si më poshtë:

- Fondi Prestigj – 1.15% (vjetore) e vlerës neto të
- Fondi Vizion – 1.15% (vjetore) e vlerës neto të aktiveve
- Fondi Pensionit – 1.5% (vjetore) e vlerës neto të aktiveve
- Fondi Raiffeisen Invest Euro – 1.30% (vjetore) e vlerës neto të aktiveve
- Fondi Miks – 1.30% (vjetore) e vlerës neto të aktiveve.

**Raiffeisen INVEST – Shoqëri Administruese e Fondeve të Pensionit dhe Sipërmarrjeve të Investimeve Kolektive sh.a.**

Shënimet shpjeguese të pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2023  
(të gjitha vlerat janë në Lek, përveçse kur është shprehur ndryshe)

**16. Tarifa e administrimit të Fondeve (vazhdim)**

Shpenzimi gjithashtu llogaritet në bazë ditore mbi Vlerën Neto të Aktiveve.

Fondi Prestigj, Vizion dhe Euro kanë aplikuar ndryshime në prospektin e Shoqërisë për t'iu përmbajtur ligjit të ri të Mbledhjes së Sipërmarrjeve të Investimit.

Shoqëria nuk ka ndarë informacion mbi alokimin e çmimit të transaksionit për detyrimet e mbetura të performancës, sepse një përafrim i çmimit të transaksionit do të përfshinte vetëm variablat e supozuar që janë të kufizuar.

**17. Të ardhura nga interesat llogaritur me metodën e interesit efektiv**

Të ardhurat nga interesi i instrumentave financiare sipas kategorive përbëhen si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2023</u>	<u>31 dhjetor 2022</u>
Obligacione të qeverise	742,556	583,000
Depozita me afat dhe llogari rrjedhese	11,422,178	1,913,973
	<u>12,164,734</u>	<u>2,496,973</u>

**18. Shpenzime personeli**

Shpenzime personeli për vitin që mbyllet më 31 dhjetor 2023 dhe 31 dhjetor 2022 detajohen si mëposhtë:

	<u>31 dhjetor 2023</u>	<u>31 dhjetor 2022</u>
Paga, shpërblime	49,403,981	49,040,775
Sigurime shoqërore	4,482,194	4,039,569
Kosto të tjera të personelit	1,407,055	1,462,286
	<u>55,293,230</u>	<u>54,542,630</u>

**19. Shpenzime të tjera operative**

Shpenzime të tjera operative për vitin që mbyllet më 31 dhjetor 2023 dhe 31 dhjetor 2022 detajohen si mëposhtë:

	<u>31 dhjetor 2023</u>	<u>31 dhjetor 2022</u>
Shpenzime të administrimit të fondeve të pensionit dhe investimeve	227,360,400	380,165,300
Marketing dhe Sponsorizime	59,978,263	99,931,921
Shpenzime të shitjes me agjent	13,037,500	14,225,900
Shpenzime mirëmbajtje	11,612,269	11,976,215
Komisione transaksionesh të paguara për shoqerine dhe fondet	5,455,499	5,899,734
Taksa	2,739,458	2,914,799
Shpenzime për bankën depozitare	845,445	732,363
Tarifë për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare	577,488	502,723
Posta	24,759	412,765
Shpenzime udhëtime dhe dieta	475,830	214,015
Sigurime	160,262	128,803
Shpenzime telefonike dhe internet	201,535	68,820
Noter dhe shpenzime ligjore	7,000	40,600
Shpenzime të tjera stafi	209,685	35,448
Të tjera	28,824,113	10,519,598
<b>Totali</b>	<u>351,509,505</u>	<u>527,769,004</u>

**Raiffeisen INVEST – Shoqëri Administruese e Fondeve të Pensionit dhe Sipërmarrjeve të Investimeve Kolektive sh.a.**

Shënimet shpjeguese të pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2023  
(të gjitha vlerat janë në Lek, përveçse kur është shprehur ndryshe)

**19. Shpenzime të tjera operative (vazhdim)**

Tarifat e tjera të administrimit të fondeve lidhen me marrëveshjen e bashkëpunimit midis Raiffeisen Bank sh.a dhe Raiffeisen Invest sh.a të datës 3 janar 2013, sipas së cilës Raiffeisen Invest sh.a angazhohet të pajisë të gjithë investitorët me një paketë shërbimesh të Shoqërisë, të ofruara nga Raiffeisen Bank sh. dhe të mbulojë nëpërmjet pagesave mujore të gjitha kostot e shërbimeve të përfshira në paketë. Për vitin 2023 kostoja e shërbimeve të paketës është 950 Lek/për investitor për muajin Janar, 650 Lek/për investitor për periudhën Shkurt-Tetor dhe 700 Lek/për person për muajt Nëntor dhe Dhjetor (2022: 950 Lek/për investitor)

Shpenzime të shitjes me agjent lidhet me marrëveshjen e bashkëpunimit mes Raiffeisen Invest sha dhe Raiffeisen Bank sha, më datë 25 janar 2012 (ndryshimi i fundit dhjetor 2019) sipas së cilës Raiffeisen Invest sha bie dakord t'i paguajë Raiffeisen Bank sha tarifën vjetore të shitjes me agjent në këmbim të përpjekjeve dhe suksesit të kësaj të fundit për të shitur fonde investimi RIAL. Për vitin 2023 cmimi i shërbimeve është 120.000 Eur (2022 – 120.000 Eur).

Referuar zërit “Tarifë për Autoritetin e Mikëqyrjes Financiare”, bazuar në rregulloren nr. 18/1, datë 15 shkurt 2010 të Bordit të Autoritetit të Mbikqyrjes Financiare (të rishikuar në 6 tetor 2011), shoqëritë e administrimit të fondeve të pensioneve dhe të investimeve duhet të paguajnë kundrejt Autoritetit të Mbikqyrjes Financiare për Fondin e Pensionit një tarifë vjetore prej 0,05% të vlerës së aktiveve në fund të çdo dhe pagesa behet fund të çdo tremujori. (2022: 0,05% të vlerës së aktiveve në fund të çdo dite dhe pagesa behet në fund të tremujorit për fondet e pensioneve).

**20. Tatim mbi fitimin**

Shoqëria ka përcaktuar tatimin në fund të vitit në përputhje me legjislacionin shqiptar. Në 2023, norma e tatimit në Shqipëri është e barabartë me 15% (2022: 15%) e fitimit të tatueshëm. Më poshtë paraqitet rakordimi i tatimit mbi fitimin i përllogaritur me normën e aplikueshme të tatimit me fitimin kontabël:

	<u>31 dhjetor 2023</u>	<u>31 dhjetor 2022</u>
Tatim fitimi korrent	62,503,250	97,687,261
Taksat e shtyra		
<b>Totali</b>	<b><u>62,503,250</u></b>	<b><u>97,687,261</u></b>
Rakordimi i mëposhtëm tregon marrëdhënien mes fitimit para dhe pas normës efektive të tatimit:		
	<u>2023</u>	<u>2022</u>
Fitimi para tatimit	<u>99,262,280</u>	<u>163,956,657</u>
Shpenzimi i tatim fitimit teorik duke përdorur normën 15%	14,889,342	24,593,499
Efekti i tatimit:		
Të ardhurat përjashtuar taksën		
Shpenzime jo të zbritshme	47,613,908	73,093,762
Përdorimi i humbjeve nga tatimi të mbartur nga vitet e mëparëshme		
Barra tatimore efektive	<u>62,503,250</u>	<u>97,687,261</u>
Barra tatimore efektive, %	<u>62.97%</u>	<u>58.58%</u>

Në efektin tatimor të shpenzimeve të pazbritshme është përfshirë një shumë prej Lek 34,104,060 (2022: Lek 57,024,795) që lidhet me shpenzimet për shërbimet e marra nga Raiffeisen Bank sh.a.

## 21. Instrumentet financiare – Vlera e drejtë dhe administrimi i rrezikut

### a) Matja e vlerës së drejtë

Shoqëria i klasifikon aktivet dhe detyrimet financiare me kosto të amortizuara.

*Paraja dhe ekuivalentët e saj*

Paraja dhe ekuivalentët e saj përfshijnë llogari rrjedhëse në bankat vendase. Duke qenë se këto balanca janë afatshkurtra, vlera e tyre e drejte është konsideruar e barabartë me vlerën e tyre të mbetur.

*Aktivitetet financiare me kosto amortizuar*

Vlera e drejtë e aktiveve financiare me kosto të amortizuar është 19,679,404 ALL (2022: 22,427,872 ALL). Vlera e drejtë për këtë investim është llogaritur duke përdorur një model të skontimit të flukseve të parasë bazuar në një kurbë kthimi të përshtatshme për periudhën e mbetur të maturimit.

### b) Administrimi i rrezikut financiar

Shoqëria është ekspozuar ndaj rreziqeve të mëposhtme nga përdorimi i instrumenteve financiare:

- rreziku i kredisë
- rreziku i likuiditetit
- rreziku i tregut
- rreziku operacional

Ky shënim paraqet informacion rreth ekspozimit të Shoqërisë ndaj secilit prej rreziqeve të mësipërme, objektivave të Shoqërisë, politikave dhe proceseve për matjen dhe administrimin e rrezikut, si dhe menaxhimin e kapitalit të Shoqërisë.

#### *Struktura e administrimit të rrezikut*

Bordi i Administrimit ka përgjegjësinë e përgjithshme për krijimin dhe mbikëqyrjen e kuadrit të menaxhimit të rrezikut të Shoqërisë. Bordi është përgjegjës për zhvillimin dhe monitorimin e politikave të menaxhimit të rrezikut të Shoqërisë. Politikat e menaxhimit të rrezikut të Shoqërisë krijohen për të identifikuar dhe analizuar rreziqet me të cilat ballafaqohet institucioni financiar, për të vendosur kufizimet dhe kontrollet e përshtatshme të rrezikut dhe për të monitoruar rreziqet dhe respektimin e limiteve. Politikat dhe sistemet e menaxhimit të rrezikut rishikohen rregullisht për të pasqyruar ndryshimet në kushtet e tregut, produktet dhe shërbimet e ofruara. Shoqërisë, përmes standardeve dhe procedurave të menaxhimit, synon të zhvillojë një mjedis kontrolli të disiplinuar dhe konstruktiv, në të cilin të gjithë punonjësit i kuptojnë rolet dhe detyrimet e tyre.

#### (i) Rreziku i kredisë

Rreziku i kredisë është rreziku i humbjes financiare të Shoqërisë nëse një klient ose një palë tjetër e një instrumenti financiar nuk arrin të përmbushë detyrimet e tij kontraktuale. Për qëllime të raportimit për menaxhimin e rrezikut, Shoqëria konsideron këto elemente të ekspozimit ndaj rrezikut të kredisë (të tilla si rreziku individual i rrezikut dhe rreziku i sektorit). Bordi i Administrimit të Shoqërisë ka deleguar përgjegjësinë për menaxhimin e rrezikut të kredisë për Drejtimin, i cili është përgjegjës për mbikëqyrjen e rrezikut të kredisë të Shoqërisë. Investimet e Shoqërisë janë në bono thesaru dhe obligacione të Qeverisë Shqiptare dhe për këtë arsye Shoqëria është e ekspozuar vetëm ndaj rrezikut të kredisë së qeverisë shqiptare. Vlera kontabël e aktiveve financiare përfaqëson ekspozimin maksimal të kredisë. Ekspozimi maksimal i kredisë ndaj rrezikut të kredisë në datën e raportimit ishte:

	<u>31 dhjetor 2023</u>	<u>31 dhjetor 2022</u>
Llogari në Bank	2,438,209	27,866,821
Depozita në lek me maturim me pak se 3 muaj	541,035,616	520,673,151
	<u>543,473,825</u>	<u>548,539,972</u>

**Raiffeisen INVEST – Shoqëri Administruese e Fondeve të Pensionit dhe Sipërmarrjeve të Investimeve Kolektive sh.a.**

Shënimet shpjeguese të pasqyrave financiare për vitin e mbylltur më 31 dhjetor 2023  
(të gjitha vlerat janë në Lek, përveçse kur është shprehur ndryshe)

**21. Instrumentet financiare – Vlera e drejtë dhe administrimi i rrezikut (vazhdim)**

**(b) Administrimi i rrezikut financiar (vazhdim)**

**(i) Rreziku i kredisë (vazhdim)**

**Ekspozimi ndaj rrezikut të kredisë:**

Ekspozimi maksimal ndaj rrezikut të kredisë për llogaritë e arkëtueshme në datën e raportimit sipas llojit të rajonit gjeografik ishte:

	<b>31 dhjetor 2023</b>	<b>31 dhjetor 2022</b>
Vendase	564,022,673	570,766,694
	<b>564,022,673</b>	<b>570,766,694</b>

Cilësia e kredisë së aktiveve financiare është si vijon:

	<b>2023</b>			<b>2022</b>		
	Niveli 1	Niveli 2	Niveli 3	POCI	Totali	Totali
Qeveria e Republikës së Shqipërisë B+	20,548,848	-	-	-	20,548,848	22,226,722
Paraja dhe ekuivalentët e saj, të pa rankuara	543,473,825	-	-	-	543,473,825	548,539,972
Humbja nga zhvlerësimi	(33,963)	-	-	-	(33,963)	(40,711)
<b>Vlera kontabël</b>	<b>563,988,711</b>	<b>-</b>	<b>-</b>	<b>-</b>	<b>563,988,711</b>	<b>570,725,983</b>

**Investimet e letrave me vlerë**

Rreziku i kredisë së portofolit të letrave me vlerë të investimit vlerësohet në bazë të të dhënave historike dhe vlerësimit të aftësisë së qeverisë shqiptare për të përmbushur detyrimet e saj kontraktuale të flukseve të parasë në monedhën vendase në afatin e shkurtër.

Qeveria shqiptare është vlerësuar si B+, e qëndrueshme, bazuar në vlerësimin e Standard & Poor's dhe B1, të qëndrueshëm, bazuar në vlerësimin e Moody's.

**Paraja dhe ekuivalentët e saj**

Paraja dhe ekuivalentët e saj mbahen në bankat tregtare në Shqipëri, si Raiffeisen Bank Albania dhe First Investment Bank Albania. 99% e këtij zëri mbahet në Raiffeisen Bank dhe vetëm 1% në First Investment Bank. Vlerësimi i tyre është BB+. Shoqëria zbaton një model 12-mujor të humbjeve të pritshme dhe paraqet ekspozimet me maturim afatshkurtër në përcaktimin e zhvlerësimit të parasë dhe ekuivalentëve të saj.

Shoqëria nuk ka njohur humbje nga zhvlerësimi gjatë 2023 për paranë dhe depozitat afatshkurtra. Shuma e humbjeve nga zhvlerësimi është jo materiale për pasqyrat financiare.

**Raiffeisen INVEST – Shoqëri Administruese e Fondeve të Pensionit dhe Sipërmarrjeve të Investimeve Kolektive sh.a.**

Shënimet shpjeguese të pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2023  
(të gjitha vlerat janë në Lek, përveçse kur është shprehur ndryshe)

**21. Instrumentet financiare – Vlera e drejtë dhe administrimi i rrezikut (vazhdim)**

**(b) Administrimi i rrezikut financiar (vazhdim)**

**(i) Rreziku i kredisë (vazhdim)**

*Të arkëtueshme nga Fondet*

Normat e humbjeve bazohen në përvojën aktuale të humbjes së kredisë gjatë pesë viteve të fundit. Këto norma rregullohen me faktorë skalarë për të pasqyruar ndryshimet midis kushteve ekonomike gjatë periudhës mbi të cilën janë grumbulluar të dhënat historike, kushtet aktuale dhe pikëpamjen e Shoqërisë për kushtet ekonomike gjatë jetës së pritshme të të arkëtueshmeve.

Faktorët rregullues bazohen në pagat mesatare bruto aktuale dhe të parashikuara për Shqipërinë (2.01%).

Në tabelën e mëposhtme jepen informacione për ekspozimin ndaj rrezikut të kredisë dhe HPK më 31 dhjetor 2023 dhe 2022:

31 dhjetor 2023	Mesatarja e ponderuar e raportit të humbjes	Vlera kontabël	Humbja nga zhvlerësimi	Zhvlerësim i kredise
Në Lek				
Pa vonesa	0%	47,893,399	-	Jo
		<b>47,893,399</b>	-	
31 dhjetor 2022				
Pa vonesa	0%	43,978,033	-	Jo
		<b>43,978,033</b>	-	

Normat e humbjes për këto lloje të arkëtueshmesh për 10 vitet e fundit kanë qenë 0. Këto të arkëtueshme kanë periudhë maturimi për më pak se një javë. Për këtë arsye, Shoqëria nuk llogarit provigjon humbjesh për të arkëtueshmet nga fondi.

***Të dhënat, supozimet dhe teknikat e përdorura për përlogaritjen e zhvlerësimit***

Shiko politikën kontabël në shënimin 7(g)(vii).

***Rritje e ndjeshme e rrezikut të kredisë***

Për përcaktimin nëse rreziku i mospagimit të vlerës së investuar të një instrumenti financiar është rritur ndjeshëm që nga njohja fillestare, Shoqëria konsideron informacione të mbështetura dhe të arsyeshme, që janë të disponueshme pa kosto ose përpjekje të panevojshme. Kjo përfshin informacione dhe analiza sasiore dhe cilësore, bazuar në përvojën historike të Shoqërisë dhe vlerësimet e specialistëve të rrezikut të kreditit si dhe duke përfshirë informacione mbi të ardhmen.

Për ekspozimet ndaj qeverisë shqiptare, rreziku i kredisë konsiderohet të jetë rritur ndjeshëm që nga njohja fillestare nëse ka vonesë prej 30 ditësh ose më shumë në shlyerjen e një detyrimi ndaj Shoqërisë.

Shoqëria monitoron efektshmërinë e kritereve të përdorura për të identifikuar rritje të ndjeshme në rrezikun e kredisë, nëpërmjet rishikimeve të rregullta për të konfirmuar se kriteret janë në gjendje të identifikojnë rritje të ndjeshme të rrezikut të kredisë para se një ekspozim të jetë në mungesë.

***Përkufizimi i deshtimit***

Shoqëria konsideron që një aktiv financiar ka dështuar kur:

- debitori nuk ka gjasa të paguajë detyrimet e tij të plota ndaj Shoqërisë, pa qenë nevoja për veprime nga Shoqëria të tilla si realizimi i aktive të lëna si kolateral (nëse ka ndonjë të tillë); ose
- debitori është në vonesë prej më shumë se 90 ditësh për ndonjë ekspozim material ndaj Shoqërisë.

Në vlerësimin nëse një huamarrës është në dështim, Shoqëria konsideron tregues:

- cilësorë – p.sh. shkeljet e kushteve financiare të kontratës;
- sasiore- p.sh. vonesat në pagesë dhe mospagimi i ndonjë detyrimi tjetër nga i njëjti huamarrës; dhe
- bazuar në të dhënat e zhvilluara së brendshmi dhe të marra nga burime të jashtme.

Të dhënat e përdorura në vlerësimin nëse një instrument financiar ka dështuar dhe rëndësia e tyre mund të ndryshojë me kalimin e kohës për të pasqyruar ndryshimet në rrethana

**Raiffeisen INVEST – Shoqëri Administruese e Fondeve të Pensionit dhe Sipërmarrjeve të Investimeve Kolektive sh.a.**

Shënimet shpjeguese të pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2023  
(të gjitha vlerat janë në Lek, përveçse kur është shprehur ndryshe)

**21. Instrumentet financiare - Vlera e drejtë dhe administrimi i rrezikut (vazhdim)**

**(b) Administrimi i rrezikut financiar (vazhdim)**

**(i) Rreziku i kredisë (vazhdim)**

*Mjetet financiare të modifikuara*

Kushtet kontraktuale të një aktivi financiar mund të modifikohen për arsye të ndryshme, duke përfshirë ndryshimin e kushteve të tregut dhe faktorë të tjerë që nuk lidhen me ndonjë përkeqësim aktual ose potencial të cilësisë së kreditit të kundërpartisë. Një aktiv ekzistues, kushtet e të cilit janë modifikuar mund të çregjistrohet dhe aktivi i rinegociuar njihet si aktiv i ri me vlerë të drejtë në përputhje me politikën kontabël të përcaktuar në Shënimin 7(g)(v).

Kur kushtet e një aktivi financiar modifikohen dhe modifikimi nuk rezulton në çregjistrim, përcaktimi nëse rreziku i kredisë së aktivit është rritur ndjeshëm reflekton krahasimin e:

— PM-së përgjatë jetës së mbetur në datën e raportimit bazuar në kushtet e modifikuara; me

— PM-në përgjatë jetës së mbetur vlerësuar në bazë të të dhënave në njohjen fillestare dhe kushteve kontraktuale fillestare.

**Matje e HPK**

*Të arkëtueshme nga Fondet*

Shoqëria përdor matricën e zbritjeve për të matur HPK nga kërkesat për arkëtim nga fondet. Normat e humbjeve llogariten duke përdorur metodën e ‘normave të transferimit’ bazuar në probabilitetin e të arkëtueshmes që kalon fazat e njëpasnjëshme të mundësisë për të mos u shlyer. Normat e kalimit llogariten veçmas për ekspozime në segmente të ndryshme bazuar në karakteristikat e mëposhtme të përbashkëta të rrezikut të kredisë.

*Paraja dhe ekuivalentët e saj*

Paraja dhe ekuivalentët e saj mbahet me Bankat tregtare në Shqipëri. Shoqëria aplikon një bazë humbjeje 12-mujore dhe reflekton maturitetet e shkurtra të ekspozimeve në vlerësimin e zhvlerësimit. Në zbatimin fillestar të SNRF 9, për shkak të ekspozimeve afatshkurtra, Shoqëria nuk ka njohur një humbje nga zhvlerësimi më 1 janar 2023 dhe gjatë vitit 2022.

*Investimet e letrave me vlerë*

Të dhënat kryesore në matjen e HPK janë strukturat kohore të parametrave të mëposhtëm:

- Probabiliteti i Mospagesës (PM);
- Humbja në rast Mospagese (HM);
- Ekspozimi në rast Mospagese (EM).

Vlerësimet e PM janë vlerësime në një datë të caktuar, të cilat llogariten në bazë të të dhënave të mbledhura brenda dhe jashtë, që përbëjnë faktorë sasiore dhe cilësore.

HM është madhësia e humbjes së mundshme nëse ka një default dhe vlerësohet bazuar në parametrat e llogaritur nga agjencitë e vlerësimit.

EM përfaqëson ekspozimin e pritur në rast të një default. Shoqëria nxjerr EM nga ekspozimi aktual ndaj palës tjetër dhe ndryshimet e mundshme në shumën aktuale të lejuar sipas kontratës duke përfshirë amortizimin. EM i një aktivi financiar është vlera e tij kontabël bruto. Vlerësimet e EM janë llogaritur në bazë të fluksit të parave të skontuara duke përdorur normën efektive të interesit si faktor zbritës.

Shoqëria mat HPK duke marrë në konsideratë rrezikun e vonesës për periudhën maksimale kontraktuale mbi të cilën ai është i ekspozuar ndaj rrezikut të kredisë, edhe nëse, për qëllime të administrimit të rrezikut, Shoqëria konsideron një periudhë më të gjatë. Periudha maksimale kontraktuale zgjat deri në datën në të cilën Shoqëria ka të drejtë të kërkojë kthimin e një paradhënie.

Më 31 dhjetor 2023 dhe 31 dhjetor 2022, Shoqëria nuk kishte aktive financiare të zhvlerësuara.



**Raiffeisen INVEST – Shoqëri Administruese e Fondeve të Pensionit dhe Sipërmarrjeve të Investimeve Kolektive sh.a**

Notes to the financial statements for the year ended 31 December 2023

*(Amounts in Lek, unless otherwise stated)***21. Instrumentet financiare – Vlera e drejtë dhe administrimi i rrezikut (vazhdim)****(ii) Rreziku i likuiditetit**

Rreziku i likuiditetit është rreziku që Shoqëria do të hasë vëshirësi në përmbushjen e detyrimeve të saj financiare.

*Menaxhimi i rrezikut të likuiditetit*

Qasja e Shoqërisë për të menaxhuar likuiditetin është të sigurojë, sa të jetë e mundur, që gjithmonë do të ketë likuiditet të mjaftueshëm për të përmbushur detyrimet e tij kur është e nevojshme, në kushte normale dhe të rënda, pa shkakuar humbje të papranueshme ose duke rrezikuar dëmtimin e reputacionit të Shoqërisë. Tabela në vijim tregon fluksat e parave të skontuara në aktivet dhe detyrimet financiare të Shoqërisë në bazë të maturimit të tyre të hershëm të mundshëm kontraktual ose rrjedhjes së parave të gatshme, pasi efekti i zbritjes nuk konsiderohet material.

<b>31 dhjetor 2023</b>	<b>Deri në 1 muaj</b>	<b>1- 3 muaj</b>	<b>3 - 6 muaj</b>	<b>6 - 12 muaj</b>	<b>Më shumë se 1 vit</b>	<b>Totali</b>
<b>Aktivët</b>						
Paraja dhe ekuivalentët e saj	543,473,825	-	-	-	-	543,473,825
Të arketueshme nga Fondet	47,893,399	-	-	-	-	47,893,399
Letra me vlerë	-	-	-	-	20,198,848	20,198,848
<b>Totali</b>	<b>591,367,224</b>	<b>0</b>	<b>-</b>	<b>-</b>	<b>20,198,848</b>	<b>611,566,072</b>
<b>Detyrimet</b>						
Detyrime të tjera	26,183,921					26,183,921
Detyrime qiraje	237,933	475,867	713,800	1,427,601	18,691,577	21,546,778
<b>Totali</b>	<b>26,421,854</b>	<b>475,867</b>	<b>713,800</b>	<b>1,427,601</b>	<b>18,691,577</b>	<b>47,730,699</b>
<b>Rreziku i likuiditetit</b>	<b>564,945,370</b>	<b>(475,867)</b>	<b>(713,800)</b>	<b>(1,427,601)</b>	<b>1,507,271</b>	<b>563,835,373</b>
<b>Kumulative</b>	<b>564,945,370</b>	<b>564,469,503</b>	<b>563,755,702</b>	<b>562,328,102</b>	<b>563,835,373</b>	

**Raiffeisen INVEST – Shoqëri Administruese e Fondeve të Pensionit dhe Sipërmarrjeve të Investimeve Kolektive sh.a**

Notes to the financial statements for the year ended 31 December 2023

*(Amounts in Lek, unless otherwise stated)***21. Instrumentet financiare – Vlera e drejtë dhe administrimi i rrezikut (vazhdim)****(iii) Rreziku i likuiditetit**

<b>31 dhjetor 2022</b>	<b>Deri në 1 muaj</b>	<b>1 - 3 muaj</b>	<b>3 - 6 muaj</b>	<b>6 - 12 muaj</b>	<b>Më shumë se 1 vit</b>	<b>Totali</b>
<b>Aktivët</b>						
Paraja dhe ekuivalentët e saj	548,472,814	-	-	-	-	548,472,814
Të arketueshme nga Fondet	43,978,033	-	-	-	-	43,978,033
Letra me vlerë	-	22,226,722	-	-	-	22,226,722
<b>Totali</b>	<b>592,450,847</b>	<b>22,226,722</b>	<b>-</b>	<b>-</b>	<b>0</b>	<b>614,677,569</b>
<b>Detyrimet</b>						
Detyrime të tjera	31,185,426					31,185,426
Detyrime qiraje	237,678	475,357	713,035	1,426,071	21,391,058	24,243,199
<b>Totali</b>	<b>31,423,104</b>	<b>475,357</b>	<b>713,035</b>	<b>1,426,071</b>	<b>21,391,058</b>	<b>55,428,625</b>
<b>Rreziku i likuiditetit</b>	<b>561,027,743</b>	<b>21,751,365</b>	<b>(713,035)</b>	<b>(1,426,071)</b>	<b>(21,391,058)</b>	<b>559,248,944</b>
<b>Kumulative</b>	<b>561,027,743</b>	<b>582,779,108</b>	<b>582,066,073</b>	<b>580,640,002</b>	<b>559,248,944</b>	<b>-</b>

**21. Instrumentet financiare – Vlera e drejtë dhe administrimi i rrezikut (vazhdim)**

**(b) Administrimi i rrezikut financiar (vazhdim)**

**(iii) Rreziku i tregut**

Rreziku i tregut është rreziku që ndryshimet në çmimet e tregut, të tilla si norma e interesit, kurset e këmbimit valutor dhe përhapjet e kreditë do të ndikojnë në të ardhurat e Shoqërisë ose në vlerën e zotërimeve të instrumenteve financiare. Qëllimi i menaxhimit të rrezikut të tregut është të menaxhojë dhe kontrollojë ekspozimet ndaj rrezikut të tregut brenda parametrave të pranueshëm, duke optimizuar kthimin në rrezik.

**Ekspozimi ndaj rrezikut të normës së interesit**

Rreziku kryesor për të cilin janë ekspozuar portofolet tregtare është rreziku i humbjes nga luhatjet në flukset e ardhshme të parave ose vlerat e drejta të instrumentit financiar për shkak të një ndryshimi në normat e interesit të tregut (Vlerat aktuale neto të aktiveve dhe detyrimeve). Rreziku i normës së interesit menaxhohet kryesisht përmes monitorimit të mangësive të normave të interesit. Aktivet financiare që mbartin interesa më 31 dhjetor 2023 dhe 31 dhjetor 2022 janë paraqitur më poshtë:

	<b>31 dhjetor 2023</b>	<b>31 dhjetor 2022</b>
Llogari në Bank	2,438,209	27,866,821
Depozita në lek me maturim me pak se 3 muaj	541,035,616	520,673,151
	<b>543,473,825</b>	<b>548,539,972</b>

**Analiza e ndjeshmërisë së vlerës së drejtë për instrumentet me normë fikse**

Shoqëria nuk mban aktive dhe detyrimet financiare me normë fikse me vlerë të drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes. Prandaj, një ndryshim në normat e interesit në datën e raportimit nuk do të ndikonte në fitimin ose humbjen. Një ndryshim prej 100 pikësh bazë në normat e interesit nuk do të kishte rritur ose ulur kapitalin.

**Ekspozimi ndaj rrezikut të kursit të këmbimit**

Shoqëria nuk është e ekspozuar në mënyrë të konsiderueshme ndaj rrezikut të monedhës pasi transaksionet në monedhat e huaja nuk janë të shpeshta. Rreziku i valutës menaxhohet përmes përdorimit të përputhjes së aktiveve dhe detyrimeve. Normat e aplikueshme zyrtare të Shoqërisë (Lek ndaj njësisë së monedhës së huaj) për monedhat kryesore më 31 dhjetor 2023 dhe 2022 ishin si më poshtë:

	<b>31 December 2023</b>		<b>31 December 2022</b>	
	<i>Fundi</i>	<i>Mesatarja</i>	<i>Fundi</i>	<i>Mesatarja</i>
USD	93.94	100.62	107.05	113.15
EUR	103.88	108.75	114.23	118.92

**(iv) Rreziku operacional**

Rreziku operacional është rreziku i humbjes së drejtpërdrejtë ose të tërthortë që del nga një shumëllojshmëri e shkaqeve të lidhura me proceset, personelin, teknologjinë dhe infrastrukturën e Shoqërisë, si dhe nga faktorë të jashtëm përveç rreziqeve të kreditit, tregut dhe likuiditetit të tilla si ato që lindin nga kërkesat ligjore dhe rregullative dhe standardet përgjithësisht të pranuar të sjelljes së korporatave përjashtuar reputacionin dhe rrezikun strategjik. Qëllimi i Shoqërisë është të menaxhojë rrezikun operacional në mënyrë që të balancojë shmangien e humbjeve financiare nëpërmjet procedurave të kontrollit që kufizojnë iniciativën dhe kreativitetin. Përgjegjësia primare për zhvillimin dhe zbatimin e kontrolleve për të adresuar rrezikun operacional i caktohet Bordit të Administrimit. Kjo përgjegjësi mbështetet nga zhvillimi i standardeve të përgjithshme të Shoqërisë për menaxhimin e rrezikut operacional në fushat e mëposhtme:

- Segregimi i duhur i detyrave, duke përfshirë autorizimin e pavarur të transaksioneve
- pajtimin dhe monitorimin e transaksioneve
- pajtueshmërinë me kërkesat rregullatore dhe ligjore
- dokumentimin e kontrolleve dhe procedurave
- Vlerësimi periodik i rreziqeve operacionale, përshtatshmëria e kontrolleve dhe procedurave
- Raportimi i humbjeve operacionale dhe veprimi i propozuar riparues
- Zhvillimi i planeve të emergjencës

**21. Instrumentet financiare – Vlera e drejtë dhe administrimi i rrezikut (vazhdim)**

**(b) Administrimi i rrezikut financiar (vazhdim)**

**(iv) Rreziku operacional (vazhdim)**

- Trajnimi dhe zhvillimi profesional, standardet etike dhe të biznesit
- zbutjen e riskut, duke përfshirë sigurimin aty ku kjo është efektive.

**22. Palët e lidhura**

Shoqëria ka një marrëdhënie palësh të lidhura me shoqërinë mëmë, Raiffeisen Bank sh.a. Më 31 dhjetor 2023 dhe 2022, Shoqëria ka hyrë në transaksionet dhe balancat e mëposhtme me palët e lidhura:

**Ndaj Raiffeisen Bank sh.a.**

	<b>31 dhjetor 2023</b>	<b>31 dhjetor 2022</b>
<b>Pasqyra e pozicionit financiar</b>		
Paraja dhe ekuivalentet e saj (Shënimi 8)	543,467,214	548,539,972
<b>Totali</b>	<b>543,467,214</b>	<b>548,539,972</b>
<b>Pasqyra e fitim ose humbjes dhe të ardhurave gjithëpërfshirëse</b>		
<b>Shpenzime</b>		
Shpenzime për transaksione	168,861	121,910
<b>Totali</b>	<b>168,861</b>	<b>121,910</b>
<b>Shpenzime (Shënimi 19)</b>		
Tarifa të tjera të administrimit të fondeve	227,360,400	380,165,300
Shpenzime të shitjes	13,037,500	14,225,900
<b>Totali</b>	<b>240,397,900</b>	<b>394,391,200</b>
Divident i shpërndarë dhe i paguar	-	122,000,000
• <b><u>Ndaj Fondeve</u></b>		
<b>Pasqyra e pozicionit financiar</b>		
Të arkëtueshme nga Fondet (Shënimi 9)	47,893,399	43,978,033
<b>Totali</b>	<b>47,893,399</b>	<b>43,978,033</b>
<b>Pasqyra e fitim ose humbjes dhe të ardhurave gjithëpërfshirëse</b>		
<b>Të ardhura (Shënimi 16)</b>		
Të ardhura nga administrimi I fondeve	498,907,219	745,181,931
Të ardhura nga tërheqjet	2,142,071	2,051,898
<b>Totali</b>	<b>501,049,290</b>	<b>747,233,829</b>
<b>Kompensimi për drejtimin kyç</b>		
<b>Shpenzime</b>		
<b>Kompensimi për personelin kyç</b>		
Përfitimet afatshkurtra	18,500,375	18,241,993
Përfitimet pas punesimit	611,275	753,487
<b>Totali</b>	<b>19,111,649</b>	<b>18,995,479</b>

**23. Ngjarjet pas datës së raportimit**

Nuk ka ngjarje të tjera të rëndësishme pas datës së raportimit që mund të kërkojnë rregullime ose paraqitje shtesë në pasqyrat financiare.